



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 22, Janar 2017

ISSN 2225-2959



KAPITALI HUMAN NË BANKA



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



1st AAB RETAIL BANKING FORUM

21 February 2017

Përmbajtja

Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave



KAPITALI HUMAN NË BANKA

KAPITALI HUMAN NË BANKA

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. **Bankieri** i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave regjtrare në veçanti.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Rr. Ibrahim Rugova,
SKY TOWER, 9/3, Tiranë
Tel: +355 4 2280371/2
Fax: +355 4 2280 359
E-mail: bankieri@aab-al.org;
www.aab.al

Bankieri

Nr.22, Janar 2017
Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Mesazhi i Kryetarit të AAB-së

Periklis DROUGKAS

Editorial

Kapitali human në banka: Sfida e ri-formatimit të stafit
Prof.Asoc.Dr. Elvin MEKA

Tema e Ditës

Sektori bankar shqiptar: Model i zhvillimit dhe përdorimit të kapitalit human

Prof. Dr. Ahmet CENI

Kapitali human në sistemin bankar shqiptar:

Sfida dhe mundësi (Intervistë)

Valbona ZENELI

Ariana TUSHI

Entela ZIGORI

Këndi i Gazetarit

Cikli i ri i rritjes dhe faktori njerëzor vendas
Ersuin SHEHU

Speciale

Bankat: Brand-i më i mirë në Shqipëri
Dr. Spiro BRUMBULLI

Sistemi Bankar

Ekzekutimi i detyrueshëm i kolateralit - disa ndryshime të rëndësishme

Albina HASANAJ

Pagesa me karta revolucion i digjital për blerjet dhe huamarrjen

Irida HUTA

Forumi i Ekspertëve

Investimet alternative,
Një rrugë drejt zhvillimit të ekonomisë reale
Fatmira KOLA

Këndi i Ekonomistit

Sfidat e politikave monetare Çfarë pritet pas masave të "lehtësimit sasior"?

Prof.Dr. Adrian CIVICI

Përgjegjshmëria Sociale

Njoftim ASD

AAB Aktivitete

AAB Trajnime

REDAKSIA:

Elvin Meka
Kryeredaktor
Eftali Peçi
Koordinatorë Produksioni
Junida Tafaj (Katroshti)
Bashkëpunëtorë
Andis Rado
Fotograf
Design & Layout: FCB Afirma
Printed by: Gentgrafik

BORDI EDITORIAL:

- 5
- 10
- 17
- 19
- 23
- 25
- 27
- 29
- 33
- 38
- 39
- 42
- Periklis DROUGKAS
Kryetar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania
- Silvio PEDRAZZI
Nënkryetar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Intesa Sanpaolo Bank Albania
- Dritan MUSTAFA
Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Tirana Bank
- Frederic BLANC
Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Societe Generale Albania
- Andi BALLTA
Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, American Bank of Investments
- Bozhidar TODOROV
Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Fibank Shqipëri
- Spiro BRUMBULLI
Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Bankave
- Hysen ÇELA
Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
- Adrian CIVICI
President i Universitetit European të Tiranës
- Enkeleda SHEHI
Drejtoreshë Ekzekutive e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

TI E DI Ç'DO TË THOTË TË TEJKALOSH LIMITET E TUA

Ti e di ç'do të thotë të sfidosh veten. Të sfidosh kohën. Të mos përkulesh kurrë para vështirësive. Të dish kur të tejkalosh limitet e tua. Të përgatitesh për të papriturat. Dhe kur të ndiesh fuqitë e tua të shterojnë, të kërkoh brenda vetes dhe t'i gjesësh sërish ato për të vazhduar rrugën e nisur...

Kjo është ajo që ti bën ditë pas dite edhe në biznesin tënd, dhe në Alpha Bank e dimë këtë. Prandaj mbështesim biznesin me zgjidhje financiare të personalizuar, të kombinuara me ekspertizën tonë vendase dhe atë ndërkombëtare, duke siguruar gjithçka që nevojitet për të ecur përpara drejt suksesit.



ALPHA BANK

Gjithmonë të sigurt, gjithmonë bashkë.

☎ 042 240 477, 🖱 www.alphabank.al



Mesazh i Kryetarit të AAB-së

I dashur lexues,

Megjithëse sektori bankar në Shqipëri e përballoi tronditjen financiare të 2008-ës me sukses, ngadalësimi ekonomik i viteve të fundit po i shtyn bankat të rivlerësojnë ofertën e tyre të huadhënies. Pas shumë vitesh zgjerimi, sektori ka hyrë në një periudhë tkurrjeje, me një rritje të aktiveve prej 5% në vit. Megjithatë, sektori financiar në vend ka qenë i qëndrueshëm dhe kohët e fundit ka treguar prirje përmirësimi, edhe pse ai vijon të përballlet me risqe thelbësore, sidomos me ato të jashtme. Bankat janë të shëndetshme, pavarësisht nivelit të lartë të huave me probleme, sistemi ka një raport të përgjithshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 16.01% në fund të gjysmës së parë të 2016-ës, i cili mbetet shumë më lart se kërkesat e Bazel-it, çka tregon se sektori ka kapitale të mjaftueshme për t'i bërë ballë kësaj prirje negative. Në këtë periudhë, sektori bankar vazhdoi të jetë fitimprurës, ku kthimi nga aktivet (RoA) dhe kthimi nga kapitali (RoE) ishin respektivisht 0.8% dhe 8%.

Angazhimi kryesor i bankave sot është dhënia e stimujve të nevojshëm për ekonominë shqiptare, për sigurimin e një rritje dhe zhvillimi të qëndrueshëm e afatgjatë. Unë besoj se, me qëndrimet dhe përgjigjet e duhura e të mirë-koordinuara, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, Qeverinë, si dhe aktorët e të tjerë të rëndësishëm, do të mund të arrijmë të promovojmë mundësi të reja për rritjen e përgjithshme dhe zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Për vitet e ardhshme, prioriteti kryesor për sektorin bankar duhet dhe do të jetë kreditimi i segmentit të ekonomive familjare dhe individëve, si një mënyrë për të rritur standardin e tyre të jetesës, si dhe ofrimin e shërbimeve të duhura financiare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që janë dhe shtylla kurrizore e ekonomisë shqiptare. Nëpërmjet mbështetjes së nismave për sipërmarrje të sapo krijuara, ne do të përmbushim rolin tonë si ofrues të levësimit të nevojshëm financiar, si dhe do të materializojmë angazhimin tonë në drejtim të punësimit të përgjithshëm.

Sfidat për sistemin bankar për vitin 2017 mbeten thujtë të njëjtat si më parë. Risqet makroekonomike, të tilla si: norma e ulët e parashikuar e rritjes, luhatjet e kursit të këmbimit për monedhat kryesore, mungesa e qartësisë mbi të ardhmen e normave të interesit, klima e biznesit nganjëherë artificialisht e pafavorshme, etj., mbeten për t'u përballuar nga sistemi bankar, duke krijuar paqartësi lidhur me vendim-marrjen afatshkurtër dhe afatgjatë. Ndryshimi i kuadrit rregullator vazhdon të jetë një sfidë për industrinë bankare, pasi sistemit i duhet të investojë një sasi të madhe kohe, përpjekjesh dhe fondesh për përmbushjen e standardeve të reja që vendosin. Një sektor bankar i larmishëm dhe i shëndetshëm është një element thelbësor i sistemit tonë financiar dhe i rëndësishëm për të pasur një ekonomi të lulëzuar. Megjithëse rregullimi deri diku është i nevojshëm, qëllimi i tij duhet të jetë, para së gjithash, garantimi i sigurisë dhe qëndrueshmërisë së institucioneve tona financiare. Risku i teknologjisë mbetet një shqetësim për sistemin bankar. Ne jemi të vetëdijshëm se bankat që nuk ja dalin përballë risive teknologjike, rrezikojnë të humbasin një pjesë të konsiderueshme të veprimtarisë bankare. Kjo është veçanërisht e vërtetë për bankat që bazohen në sisteme kompjuterike që nuk janë në gjendje të përshtaten ndaj përvojës, shërbimeve dhe produktit që pret klientela.

Si kryetar i sapo-zgjedhur i Shoqatës Shqiptare të Bankave, dua të konfirmoj angazhimin tim të plotë në forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të bashkëpunimit mes Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe grupeve të tjera të interesit, për adresimin e sfidave dhe çështjeve, me të cilat përballlet sistemi bankar.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, do të doja të falënderoja për zemërsisht paraardhësin tim, Z. Canacaris, për profesionalizmin dhe drejtimin aktiv të Shoqatës Shqiptare të Bankave, gjatë viteve të fundit.

*Singerisht,
Periklis Drougas*

abi

AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS

investo ně optimalizem

www.abi.al



Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA¹
Kryeredaktor

Që nga rihapja e tij, bankingu tregtar në Shqipëri ka qenë gjithmonë i vlerësuar si vendi më i mirë për të punuar dhe bankieri ka qenë dhe vijon të jetë profesioni më i kërkuar mes personave të diplomuar. Profesionit i bankierit në Shqipëri e ka fituar prej kohësh pozicionin e një *status simboli* në shoqëri dhe kjo për shumë arsye. Bankingu perceptohet si një profesion elitare dhe tërheqës, profesional, plotësisht formal, me të ardhura financiare mbi mesataren dhe si një vend i mirë për të përparuar në karrierë, në krahasim me profesionet e tjera në sipërmarrjen private në Shqipëri. Nga ana tjetër, bankat në Shqipëri kanë pasur luksin për të marrë *ajkën* e profesionistëve dhe studentëve më të talentuar, jo vetëm për shkak të arsyeve të sipërpërmendura, të cilat kanë qenë dhe ende janë një fakt i jetës në tregun e punës në Shqipëri, por dhe për shkak të nevojave reale të tyre për të punësuar staf të aftë dhe eficient, për të kryer dhe përmbushur detyrat dhe kërkesat profesionale, ashtu siç ato kërkojnë dhe përmbushen në vendet e origjinës së këtyre bankave. Deri më

Kapitali human në banka: Sfida e ri-formatimit të stafit



Sigurisht, bankingu nuk do të vdesë, por teknologjia dhe konkurrenca e jashtme do të kërkojnë një ri-formatim thuajse total të punës në bankë. Këtu do të jenë të nevojshme aftësi të reja, për të zhvilluar dhe mirëmbajtur teknologjitë e reja. Bankat do të duhet të rishikojnë organizimin e tyre të përgjithshëm, të ri-trajtojnë dhe ri-shpërndajnë stafin në pjesë të tjera të organizatës dhe të përpiqen të krijojnë një fuqi punëtore të së ardhmes, mbi bazën e pritshmërive të një brezi të ri bankierësh dhe konsumatorësh, të armatosur fort me teknologji.



tani, industria bankare i ka përmbushur pritshmëritë e përgjithshme të personave që kanë punësuar, apo ende aspirojnë dhe kërkojnë të punësohen pranë bankave në të ardhmen. Megjithëse industria bankare në rrafsh global u godit fort në krenarinë dhe statusin e saj elitare, për shkak të tronditjeve dhe goditjeve që krizat e fundit globale financiare dhe ekonomike të vitit 2008 shkaktuan në ekonomi, veprimtarinë e biznesit dhe financat personale, si në nivel global, kombëtar dhe lokal, bankat në Shqipëri ia dolën të mbeten thuajse të padëmtuara nga rreziku i reputacionit. Ato mbeten ende një nga vendet më të mira për të punuar dhe profesioni i bankierit ende është profesioni më i kërkuar midis studentëve dhe jo vetëm.

Megjithatë, bankingu po ndryshon dhe po ndryshon shpejt, në sajë të Revolucionit të Katërt Industrial, apo digjitizimit dhe digjitalizimit. Kjo erë e ndryshimit po fryn edhe në Shqipëri dhe bankat po e ndjejnë nevojën urgjente për t'u përshtatur ndaj epokës së revolucionit digjital dhe teknologjisë. Një studim i fundit i *McKinsey-t* në vitin 2016, tregoi se "*teknologjitë e sotme në përdorim mund të automatizojnë rreth 45 për qind të veprimtarive njerëzore të pagueshme dhe se mbi 60 për qind e të gjitha profesioneve mund të përjetojnë një automatizim 30 për qind ose më*

shumë të veprimtarive të tyre përbërëse, gjithnjë me teknologjitë që janë sot në përdorim". Thënë kjo, si dhe duke pasur parasysh faktet që bankat veprojnë në mjedise me norma shumë të ulëta interesi e me rritje modeste ekonomike, një mënyrë që ato të minimizojnë këto efekte jo-pozitive është përmbushja e objektivave rigorozë të uljes së kostove, d.m.th. shfrytëzimi i mundësive për automatizim gjithnjë e më të madh të punës, mbyllja e vendeve të punës, mbyllja e degëve, etj. Sigurisht, bankingu nuk do të vdesë, por teknologjia dhe konkurrenca e jashtme do të kërkojnë një ri-formatim thuajse total të punës në bankë. Këtu do të jenë të nevojshme aftësi të reja, për të zhvilluar dhe mirëmbajtur teknologjitë e reja. Bankat do të duhet të rishikojnë organizimin e tyre të përgjithshëm, të ri-trajtojnë dhe ri-shpërndajnë stafin në pjesë të tjera të organizatës dhe të përpiqen të krijojnë një fuqi punëtore të së ardhmes, mbi bazën e pritshmërive të një brezi të ri bankierësh dhe konsumatorësh, të armatosur fort me teknologji.

Me fjalë të thjeshta, tashmë ka ardhur koha që bankat në Shqipëri t'i bashkohen me detyrimin biznesit të ri-formatimit të stafit të tyre!

¹ Zv.Rektor për Procesin Akademik, UET



Prof. Dr. Ahmet CENI

Fakulteti i Ekonomisë
UNIVERSITETI I TIRANËS

Sipas përkufizimeve nga shumë autorë, por edhe OECD, kapitali human “është tërësia e njohurive, kualifikimeve, kompetencave dhe karakteristikave individuale që krijojnë mundësinë e krijimit të mirëqenies personale, sociale dhe ekonomike” (OECD, 2001). Kapitali human përfaqëson një pasuri të paprekshme, që bën të mundur rritjen ose mbështetjen e produktivitetit, inovacionit, punësimit dhe përparësisë konkurruese. Sipas disa studimeve, në se çdo person do të shtonte afatin e studimit me një vit, produktiviteti ekonomik i vendit për banor do të rritej në një afat të gjatë në një interval 4-6%. Duke kuptuar rëndësinë e kësaj lidhje, drejtuesit e bankave kanë zbatuar një strategji që synon të gjejë dhe zhvillojë njerëzit më të përshtatshëm, më cilësorë dhe t’i motivojnë maksimalisht ata. Në kushtet e Shqipërisë, mjeshtritë dhe specialitetet e kërkuara nga sektori

Sektori bankar shqiptar: Model i zhvillimit dhe përdorimit të kapitalit human



Instrumentet e rritjes dhe përdorimit të kapitalit njerëzor si dhe matja e produktivitetit të tij në sektorin bankar janë një teori dhe praktikë universale, e cila duhet studiuar në vazhdimësi dhe zbatuar nga menaxherët përgjegjës të bankave, me synim rritjen e përfitueshmërisë nga njëra anë dhe zbatimin e përgjegjësiwe sociale, si ndaj depozituesve, huamarrësve dhe grupeve të tjera të interesit nga ana tjetër.



bankar janë afërsisht të njëjta. Nga ana tjetër, natyra e njëjtë e mjeshtrive dhe e kompetencave nuk i ka penguar bankat që të ruajnë etikën dhe individualitetin në rekrutimin e njerëzve, por edhe të bashkëpunojnë në diferencimin e rekrutimit, duke akumuluar kapitalin human më të përshtatshëm, për të përballuar objektivat afatshkurtër dhe ato strategjike. Burimet e rekrutimit për bankat kanë qenë kryesisht shkollat e larta, në programet bachelor dhe master, por edhe më lart. Procedurat e rekrutimit janë karakterizuar nga transparenca dhe theksi vendoset te aftësitë dhe potenciali i individit për të kryer detyrën, aktualisht dhe në perspektivë, duke përballuar hapat e karrierës të parashikuar në rrjetat e shpërblimit. Numri mesatar i stafit të rekrutuar në vit, është afërsisht 440 veta, ose 7% e stafit, që ka shërbyer dhe për të rifreskuar stafin nga pikëpamja e moshës, potencialit, etj. Si rrjedhojë, moshja mesatare e stafit arrin në 35.3 vjeç dhe mediana ka vlerën 35.0 vjeç, ndërsa intervali, nga minimumi te maksimumi i moshës mesatare të punonjësve, sipas bankave, luhetet nga 33 deri 37 vjeç. Ky proces e ka rritur

potencialin, por njëkohësisht e ka bërë atë të larmishëm nga pikëpamja e specialiteteve, kualifikimeve dhe e njerëzve që e disponojnë atë, duke i dhënë garanci bankave për një sukses afatgjatë.

Në vazhdim dhe i lidhur me procesin e rekrutimit, në funksion të shtimit të kapitalit njerëzor ka qenë dhe vazhdon të jetë edhe trajnimi, duke ndikuar në rritjen e kompetencave të punonjësve ekzistues. Planet e formimit janë ndërtuar duke pasur parasysh nevojat individuale të punonjësve, për të përballuar kërkesat që vijnë nga krijimi i vendeve të reja të punës dhe modernizimi i atyre ekzistuese. Këto janë realizuar nëpërmjet një katalogu, ku evidentohen nevojat apo kërkesat individuale si në afatshkurtër, ashtu edhe në aspektin strategjik. Gjatë vitit 2015 numri i ditëve të shpenzuara mesatarisht për një punonjës për trajnim është 2.1 ndërkohë që në disa banka janë shpenzuar nga 6 deri në 13 ditë. Edhe shpenzimet e formimit, si rezultat i përdorimit të formave të ndryshme të tij brenda dhe jashtë bankave, janë të konsiderueshme, ku shpenzimet mesatare për një të formuar për të

gjitha bankat arrijnë në 19,433 lekë. Konstatohet edhe një korrelacion midis trajnimit dhe rezultateve financiare të bankave, dukuri e cila vihet re edhe në eksperiencën e bankave të tjera në botë, të cilat i kanë shpenzimet e trajnimit deri në masën 4% të fondit të pagave. Si pasojë, është rritur numri i specialistëve me kualifikim, kompetenca dhe kapacitet për të kryer punët në standarde maksimale, jo vetëm në nivele më të larta drejtuese, por edhe në nivelet hierarkike më të ulëta. Numri i punonjësve në drejtorinë qendrore në nivele me klasifikim më të lartë, ndryshon sipas bankave duke ruajtur, raporte nga 50% në 60% të numrit të punësuarve. Nga ana tjetër, nga analiza e strukturës së punonjësve bankarë dhe jo bankarë, konstatohet se mbi 99% e punonjësve i përkasin drejtpërdrejt sektorit bankar, si rezultat i procesit të nën kontraktimit të shërbimeve, gjë e cila ka ndikuar në specializimin e punonjësve dhe menaxherëve në kryerjen e operacioneve bankare. Rritja e kapitalit njerëzor në banka është shoqëruar me masa dhe programe për rritjen e nivelit të motivimit dhe angazhimit të punonjësve, për të bërë të mundur rritjen e eficientë së këtij kapitali, duke respektuar kriterin etik dhe ekonomik. Nga shumë studime konstatohet se shkalla e motivimit të punonjësve të sistemit bankar është më e lartë në krahasim me sektorë të tjerë të ekonomisë. Paga mesatare për një punonjës në sistemin bankar është rreth 47 % më e madhe se paga mesatare në shkallë vendi. Kjo situatë shpjegohet me zhvillimin e ri të këtij sektori dhe prioritetit të punësimit të specialistëve me standarde të larta. Sot, bankat në Shqipëri zhvillohen në kushtet e një konkurrence të ashpër, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Shpërblimi i ofruar punonjësve të bankave, në një masë të konsiderueshme është i varur nga shpërblimi i kapitalit human që ofron tregu. Nga ana tjetër, struktura e shpërblimit në sektorin bankar është më e larmishme se ajo në sektorët e tjerë. Krahas pagës bazë, punonjësit e bankave përfitojnë edhe shtesa në varësi të nivelit të realizimit të ecurisë

së vendit të punës, si dhe përfitime të ndryshme, si: sigurime shoqërore dhe shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi, hua me interes të ulët për shtëpi, trajnime, etj. Raporti midis pagës bazë dhe shtesave për ecuri dhe përfitimeve të tjera sociale, të cilat nuk paguhen në sektorë të tjerë, shkon afërsisht deri në 30% të pagës mesatare¹. Kjo strukturë e shpërblimit zbatohet në thuajse mbi 90% të punonjësve të sektorit bankar, e cila konsiderohet një strukturë konstante dhe jo “dumping” i procesit të shpërblimit, pasi ato kanë si qëllim që të tërheqin dhe të zhvillojnë sa më shumë kapital njerëzor. Krahas rritjes së shkallës motivimit dhe angazhimit, sektori bankar ka avantazh në krahasim me sektorët e tjerë edhe në procesin njerëzor, që do të thotë se metodat e zbatuara për menaxhimin e njerëzve janë më bashkëkohore dhe më efektive, duke i trajtuar njerëzit si pasuri që krijojnë vlerë të çmuar. Nga ana tjetër, ato janë edhe një vlerë e çmuar që kushton, prandaj në këtë kuadër është e nevojshme që bankat të matin treguesit e produktivitetit të kapitalit njerëzor, i cili krahas treguesve të tjerë që rekomandohen, do të sugjeroja që tre treguesit më kryesorë të llogariten dhe analizohen nga bankat në periudha vjetore ose edhe më të shkurtra. Këto tregues janë: (i) produktiviteti i matur me vlerën e shtuar; (ii) krijimi dhe rritja e imazhit dhe (iii) shkalla e zbatimit të një kulture globaliste.

Treguesi i produktivitetit shprehet me raportin midis vlerës së shtuar të krijuar dhe shpenzimeve për paga. Në kushtet e sektorit bankar shqiptar ky raport paraqitet mesatarisht 2.2, ndërsa treguesi i medianës 1.0, që do të thotë se ka shmangie si rezultat i veprimtarive të diferencuara të bankave. Disa banka këtë tregues e kanë negativ (-0.2 dhe -0.7), ndërsa grupi me produktivitet më të lartë paraqitet me tregues +6.3, +5.8 dhe +4.0, por grupi më i madh i bankave paraqitet në intervalin +0.9 deri në +1.9. Të gjithë këta tregues janë të kënaqshëm, me përjashtim të produktivitetit negativ, i cili ndikohet nga vendimet për të ristrukturuar huat me probleme. Tregues tjetër, lidhur me

produktivitetin, është edhe përqindja e huave me probleme, rritja e së cilës ndikon në uljen e produktivitetit. Treguesi i huave me probleme arriti në 21.3% në fund të shtatorit, për rrjedhojë duhet një analizë e kujdesshme e procedurave të zbatuara dhe lidhjen e këtij fenomeni me gjendjen dhe cilësinë e kapitalit human. Tregues tjetër shumë i rëndësishëm paraqitet imazhi dhe besueshmëria e bankave, që nuk është vënë në diskutim asnjëherë, me gjithë informimet lidhur me rreziqet e depozitave në vende të tjera dhe pasojat e mundshme mbi depozitat e bankave shqiptare. Besueshmëria është rrjedhojë e imazhit që kanë klientët për bankat dhe konsiderohet si kapital apo aktiv jo-material, të cilin bankat duhet të përpiqen ta ruajnë dhe ta rrisin edhe më shumë.

Në kushtet e reja pas krizës financiare, duhet punuar me kujdes dhe në mënyrë specifike me procesin e dhënies së huave, qoftë me analizën e klientëve që kërkojnë hua, ashtu edhe atë të mirë-menaxhimit të depozitave. Produktiviteti i kapitalit human sipas këtij kënd vështrimi mund të matet me treguesin e indeksit të numrit të klientëve nga një vit në tjetrin, i cili në kushtet e Shqipërisë ka ardhur duke u përmirësuar. Lidhur me shkallën e përdorimit të një kulture globaliste dhe të përparuar, mund të jetë e nevojshme të matet numri i procedurave të menaxhimit operacional që zbatohen sipas praktikave më të mira botërore, si dhe jetësimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit, cilësia dhe efekti i procedurave të menaxhimit të burimeve njerëzore, niveli i teknikës dhe teknologjisë së përpunimit të informacionit, etj.

Instrumentet e rritjes dhe përdorimit të kapitalit njerëzor si dhe matja e produktivitetit të tij në sektorin bankar janë një teori dhe praktikë universale, e cila duhet studiuar në vazhdimësi dhe zbatuar nga menaxherët përgjegjës të bankave, me synim rritjen e përfitueshmërisë nga njëra anë dhe zbatimin e përgjegjësive sociale, si ndaj depozituesve, huamarrësve dhe grupeve të tjera të interesit nga ana tjetër.

¹ Llogaritjet janë bërë nga autori i shkruarit duke u bazuar në praktikat dhe raportet mbi bankat.

Kapitali human në sistemin bankar shqiptar: Sfida dhe mundësi

Intervistë e Kryeredaktorit të Revistës BANKIERI me disa drejtues të njësive të Burimeve Njerëzore në banka

BANKIERI:

Si e vlerësoni rolin dhe rëndësinë e stafit të sistemit bankar shqiptar dhe sa sfiduese është mbajtja dhe zhvillimi i një kapitali human të përshtatshëm në industrinë bankare, veçanërisht pas krizës së fundit globale financiare?



Valbona Zeneli
Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore, Raiffeisen Bank Shqipëri:

Sfida më e madhe sot për departamentet e Burimeve Njerëzore të bankave shqiptare janë rekrutimi, mbajtja dhe motivimi i punonjësve, zhvillimi i menaxhereve dhe kultura e korporatës. Ndërkohë që burimet njerëzore po priren të ndërmarrin një rol me strategjik, trajtimi i këtyre çështjeve është një proces i vazhdueshëm, që kërkon shumë

kohë e mbi të gjitha, një ndërgjegjësim të madh nga ana e menaxhimit të lartë. Mbajtja dhe motivimi i punonjësve është kthyer në një nga çështjet më të ndjeshme e delikate të viteve të fundit. Krijimi i një mjedisi pune ku punonjësit të ndihen të motivuar është një sfidë me të cilën hasen të gjithë profesionistët e burimeve njerëzore.

Zhvillimet e vullshme në tregun e punës kanë bërë që departamentet e burimeve njerëzore të hartojnë planet e tyre të vazhdimësisë dhe të venë theksin mbi zhvillimin e udhëheqësve të ardhshëm. Firmat e suksesshme që angazhohen ndaj zhvillimit të menaxherëve të tyre, zbatojnë në të njëjtën kohë edhe plane të tjera mbështetëse për mbajtjen sa më gjatë të punonjësve. Kjo kërkon procese dhe plane të mbështetura në një qellim të qartë dhe vizion afatgjatë. Fatkeqësisht, firmat shpeshherë kanë vështirësi të shpërndajnë buxhetet e nevojshme për të organizuar trajnimet dhe programet e zhvillimit, që janë të nevojshme për rritjen profesionale të punonjësve të tyre. Punëdhënësit më të mirë dhe me të suksesshëm janë ata të cilët kanë një kulturë të mirë të korporatës. Ata kanë shumë më pak rrjedhje të stafit sesa konkurrentet e tyre dhe janë të aftë të rekrutojnë talente, që i përshtaten më së miri kulturës dhe nevojave të tyre. Në përfundim, kjo sjell një shërbim cilësor më të mirë të klientët dhe krijon produkte novatore, të cilat sigurojnë suksesin financiar të firmës. Shumë firma

i kushtojnë shumë pak rëndësi kulturës së organizatës, por është provuar se krijimi dhe menaxhimi i kulturës nëpërmjet rekrutimit, mbajtjes dhe zhvillimit të punonjësve mund të përmirësojë dukshëm ecurinë, përfitueshmërinë dhe rritjen e një organizate.



Ariana Tushi
Drejtoreshë e Departamentit të Burimeve Njerëzore

Banka Kombëtare Tregtare:

Në një botë që ndryshon e zhvillohet shpejt, Kapitali Human ka qenë e mbetet faktori më i rëndësishëm në realizimin e objektivave strategjike të BKT për të mbajtur përparësinë konkurruese në tregun bankar. Vlerësimi i punonjësit, si aktiviteti më i çmuar i bankës, është një realitet i prekohshëm dhe i njohur nga të

gjithë punonjësit e saj. Jo rastësisht, një nga vlerat më të spikatura të BKT është: “Njerëzit të Parët”, që për të gjithë ne nënkupton kujdes maksimal për të pasur: Klientë dhe Punonjës të kënaqur! Ecuria e BKT-së mbështetet së pari dhe mbi të gjitha te punonjësit e saj. Veprimtaritë e zhvillimit të talenteve kanë në fokus tre prioritete: ndërtimin e kapaciteteve të lidërshpit; mbajtja e një mjedisi që mbështet ecurinë e qëndrueshme; dhe nxitja e zhvillimit profesional e personal të të gjithë punonjësve. Rezultatet mjaft pozitive dhe të qëndrueshme të bankës



Fokusi ynë edhe në vijim do të përqendrohet në detyrën tonë transformuese si agjent ndryshimesh dhe partner biznesi për zbatimin e strategjisë së bankës në erën digjitale, maksimizimin e ndikimit të kapitalit human, nëpërmjet rritjes së eficiencës, aftësive të reja, profesionalizmit bazuar në trajnim e të mësuarit e vazhdueshëm, në krijimin e vlerës së shtuar dhe gjetjes së ekuilibrit në tre drejtimet e rëndësishme : Klient-Punonjës-Rezultate.



në këto dy dekada tregojnë që jemi në rrugën e duhur për mbajtjen e një force pune të mirë-edukuar e të mirë-trajnuar, të përkushtuar e të motivuar. BKT ndër vite, si dhe në 2016-ën, është vlerësuar si Fituese e 3 Çmimeve më të rëndësishme ndërkombëtare për industrinë bankare si Banka Më e Mirë në Shqipëri, nga revistat prestigjioze “EMEA Finance”, “Euromoney” dhe së fundmi nga “The

Banker”. Gjithashtu, banka është vlerësuar me vlerësimin maksimal AAA (Alb) për Qeverisjen e Korporatave nga JCR Eurasia Rating në nëntor 2016, ku ndër të tjerash theksohet edhe vlerësimi i Burimeve Njerëzore dhe i Performancës së saj me notën: “Shkëlqyer” për zbatimin e praktikave më të mira bashkëkohore në fushën e burimeve njerëzore. Jetësimi i praktikave më të mira ndërkombëtare në menaxhimin strategjik të burimeve njerëzore, ka integruar në mënyrë të natyrshme interesat e bankës me interesat e punonjësve, si dhe ka rritur qëndrueshmërinë e stafit dhe kënaqësinë në punë të punonjësve. Investimi gjatë gjithë ciklit të jetës së punonjësit, përcaktimi, njohja dhe zbatimi korrekt e transparent i politikave të zhvillimit të karrierës, shpërblyerimit dhe mirënjohjes, motivimit, paketës nxitëse të përfitimeve financiare dhe jo-financiare, përtej të drejtave ligjore për mirëqenien e tyre financiare, fizike dhe emocionale, në përputhje me ecurinë individuale dhe eksperiencën e punës, etj., ka krijuar besimin te çdo punonjës se BKT është vendi i duhur për çdo punonjës që aspirojnë të realizohet në karrierë. Në këtë kuadër, mendoj, që edhe analizat periodike të mbi 20 treguesve kryesorë të ecurisë (KPI) të kapitalit njerëzor për të gjithë sistemin bankar në Komitetin e Burimeve Njerëzore, kanë ndihmuar në krahasimin me praktikatat më të mira dhe pikën e referencës, (jo vetëm me vetveten ndër vite), dhe marrjen e masave për përmirësimin e tyre aty ku duhet. Matja çdo vit e angazhimit dhe kënaqësisë në punë të punonjësve nëpërmjet anketimit anonim të tyre, është një mjet komunikimi organizativ që ndihmon në njohjen e fokusimit e prioriteteve për vitin në vazhdim.

Fokusi ynë edhe në vijim do të përqendrohet në detyrën tonë transformuese si agjent ndryshimesh dhe partner biznesi për zbatimin e strategjisë së bankës në erën digjitale, maksimizimin e ndikimit të kapitalit human, nëpërmjet rritjes së eficiencës, aftësive të reja, profesionalizmit bazuar në trajnim e të mësuarit e vazhdueshëm, në krijimin e vlerës së shtuar dhe gjetjes së ekuilibrit në tre drejtimet e rëndësishme: Klient-Punonjës-Rezultate.



Entela Zigori
Drejtoresh e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Organizimit
Intesa Sanpaolo Bank Albania:

Sistemi bankar si faktor i rëndësishëm i sistemit financiar të vendit luan një rol thelbësor në zhvillimin e ekonomisë shqiptare dhe sot bankat janë absolutisht të vetëdijshme se, në kushtet e një tregu të tejmbushur, tepër konkurrues dhe sfidues, kapitali human është mjeti më i çmuar që bën ndryshimin. Tashmë jemi të gjithë të ndërgjegjshëm se, pavarësisht madhësisë së shoqërisë, nëse arrin të ndërtohet një skuadër të përbërë nga profesionistë dhe ekspertë të motivuar, atëherë zotëron çelësin që hap dyert drejt një biznesi të suksesshëm. Të jesh një bankë atraktive për punëkërkuarë, të mbash dhe të zhvillosh kapitalin human për të kryer me profesionalizëm detyrat e kërkuara, nuk është një sfidë e lehtë për tu arritur, dhe kjo vështirësohet edhe më tepër pas krizës së fundit globale e financiare dhe presioneve që ajo ushtron mbi ekonominë. Sigurisht kompensimi financiar është një mjet që shërben për të motivuar punonjësit, por nuk duhet anashkaluar fakti që, punonjësit i japin një vlerë të rëndësishme edhe formave të tjera të shpërblyerimit dhe njohjes së meritave, që shumë shpesh kontribuojnë në përforsimin e ndjenjës së vet-vlerësimit dhe vet-realizimit. Gjithsesi, stafi është shumë më i motivuar kur punëdhënësi e mbështet atë dhe i ofron një vizion të qartë dhe një perspektivë zhvillimi profesional për të ardhmen. Pra, sfida



SMART

Tashmë për Bizneset!

Aplikacioni
i parë për
bizneset



Shkarkoje në



**BKT Smart aplikacion bankar,
që mundëson kryerjen e gjithë
veprimeve financiare sipas
modelit të biznesit tuaj!**



vazhdon...

4 22 66 288 | www.bkt.com.al



më e madhe e sistemit bankar është që të mbajë dhe të arrijë të krijojë një forcë pune të motivuar, të orientuar në arritjen e objektivave, por edhe fleksibël ndaj ndryshimeve të vazhdueshme. Në vizionin tonë, motivimi për të sjellë risi, zhvillimi dhe përforsimi i ndjenjës së përkatësisë të punonjësve, ndarja dhe përhapja e vlerave etike dhe e kulturës së bankës, angazhimi për të përmirësuar vazhdimisht proceset dhe shërbimin e klientelës, janë elementet thelbësore që na shërbejnë jo vetëm për të marrë rezultatet më të mira nga punonjësit tanë, por edhe për të mbajtur pranë dhe zhvilluar kapitalin human.

BANKIERI:

Cilat janë vështirësitë dhe pengesat kryesore në rekrutimin e një stafi cilësor në bankat tregtare?

Valbona Zeneli

Në një klimë pozitive të ndryshimit dhe përmirësimit të kushteve ekonomike, bankat duket se po rifitojnë sigurinë për të punësuar. Punëdhënësit po kërkojnë për rekrutime të reja, profesionistët po aplikojnë për vendet e shpallura të lira, por ka një sërë vështirësish të cilat nuk sjellin plotësimin e këtyre nevojave të përbashkëta, si:

Buxhete të limituara. Ekonomia po pëson rritje, por menaxherët e firmave të ndryshme kanë një përjasje mosbesimi ndaj asaj që pritet të ndryshojë. Sipas një studimi të Robert Half, 67 % e drejtuesve financiarë do të rrisin numrin e punonjësve nëse do të përmirësojnë aftësitë e tyre në huadhënie. Ndërsa 86% e të anketuarve mendojnë se rritja e mundësisë së financimit do të çojë në reduktimin e papunësisë.

Mungesë e kandidatëve të aftë. Në industrinë bankare ky problem është shumë i mprehtë dhe po kthehet në sfida gjetja e njerëzve me nivelin e duhur të kompetencave të kërkuara. Firmat ndikohen dukshëm nga zhvillimet e shumta teknologjike, ndaj edhe niveli i ekspertizës që kërkojnë te kandidatët diktohet nga këto zhvillime. Ndërkohë që bëhet gjithmonë dhe më e vështirë rekrutimi i kandidatëve të cilët janë të pajisur me njohuritë e duhura teknike për plotësimin e nevojave të pozicioneve vakante.

Numri i madh i aplikimeve. Punëdhënësit marrin një numër të madh aplikimesh, që në shumicën e rasteve nuk plotësojnë kriteret që pozicionet kërkojnë, por kjo rrit edhe nivelin vështirësisë për të bërë përzgjedhjen e duhur të kandidatëve të vlefshëm. Në disa raste kjo mund të sjellë edhe vonesa të tejzgjatura të këtyre proceseve, ku kandidatet e përzgjedhur mund të kenë pranuar oferta të tjera pune. Punëdhënësit e sotëm duhet të gjejnë metoda novatore për të tërhequr talentet e reja, nëpërmjet rrjeteve sociale, postimit të vendeve vakante në buletine të ndryshme, por edhe nëpërmjet metodave më tradicionale si ato të panairëve të punës ose dërgimit të njoftimeve/reklamave për të stimuluar interesin e përgjithshëm. Edhe në periudhat me papunësi të lartë, firmat e ndryshme që operojnë në sistemin e sotëm bankar dhe me orientim drejt teknologjive bashkëkohore gjejnë një numër të pakët të kandidatëve me aftësitë dhe trajnimet e duhura, për të përmbushur siç duhet kërkesat e pozicioneve të kërkuara.

Ariana Tushi

Ne i kushtojmë vëmendje punësimit të rinjve dhe mbështesim të sapodiplomuarit bazuar në meritën dhe praktikën transparente të rekrutimit, pasi ata kanë nevojë me shumë për mbështetje, punësim dhe përballje me sfidat e botës së punës. Mosha mesatare e punonjësve bankarë është 33 vjeç, me një harmonizim të përkryer të brezave dhe shkëmbim të njohurive/eksperiencave midis tyre, ku 74% i takon punonjësve të gjeneratës së mijëvjeçarit.

Gjithsesi, vështirësi më të mëdha hasen kryesisht në rekrutimin e stafit për degët jashtë Tiranës, ku pavarësisht njoftimeve nëpërmjet gjithë kanaleve të mundshme për vende të lira pune, numri i aplikantëve ka qënë mjaft i ulët, gjë që cenon cilësinë e rekrutimit, ose vështirëson plotësimin e nevojës për staf. Gjithashtu, vitet e fundit, për shkak të emigrimit të punonjësve IT me eksperiencë manaxheriale, tregu po ndjen vështirësi edhe në zëvendësimin/formimin e shpejtë të tyre. Një tjetër vështirësi lidhet me qarkullimin më të lartë të punonjësve gjatë vitit të parë të punës, si pasqyrim i pritshmërive më të larta të tyre në raport me ecurinë, në një

kohë mjaft të shkurtër në bankë. Këtu duhet punuar më shumë për qartësimin e pritshmërive të tyre që në procesin e përzgjedhjes, pasi reduktojmë kostot, kohën dhe energjinë. Çdokush që zgjedh bankën si institucion prestigjioz e punëdhënës model, dhe dëshiron që të zhvillojë një karrierë afatgjatë aty, duhet ta përgatisë veten për rrugën e sigurt të karrierës në përputhje me ecurinë/meritën, edhe duke filluar nga pozicioni i nderuar i arkëtarit, për të arritur kudo ku ai synon. Gjithashtu, përmirësimi i raportit gjinor në bankë, në favor të meshkujve mbetet për t'u përmirësuar në vijim, pasi punonjëset femra përbëjnë 75 % të stafit bankar.

Entela Zigori

Qëllimi ynë është të punësojmë jo vetëm dhe thjesht një staf cilësor, profesionist, por punonjës të përgjegjshëm, të besueshëm, në mënyrë që veprimtaria jonë të bëhet më efciente, fitimprurëse dhe njëkohësisht shumë më e qëndrueshme në terma afatgjatë. Bankat ofrojnë pozicione të ndryshme pune në pjesën më të madhe për të diplomuarit dhe të specializuarit në menaxhim biznesi, financë, inxhinieri informatike, matematikë si edhe në shumë fusha të tjera. Banka jonë në mënyrë të vazhdueshme synon të gjejë kandidatë që jo vetëm zotërojnë aftësitë e kërkuara për të kryer detyrat specifike që do tu ngarkohen, por që janë gati të bëhen pjesë e një udhëtimi transformues për të paraprirë sfidat e sotme dhe për t'u përballur me sfidat që do të ofrojnë e nesërmja.

Të jesh pjesë e një prej grupeve më të mëdha bankare, do të thotë të kesh një mjedis të brendshëm të karakterizuar nga ndërvarësitë në rritje mes strukturave të ndryshme në nivel bankë dhe në të njëjtën kohë në nivel grupi. Për këtë qëllim, jemi në kërkim të punonjësve që kanë aftësi bashkëpunimi dhe ndërveprimi brenda organizatës, me shumë struktura njëkohësisht. Kompetenca të tilla si: “aftësia për të menaxhuar marrëdhënien me klientin”, “aftësia për të punuar në skuadër” mbeten ndër ato më të rëndësishmet, duke vijuar më pas me kompetenca si: “fleksibiliteti dhe aftësia për t'u përshtatur”, “kapaciteti për të komunikuar me shkrim dhe verbalisht”,

“zgjidhja e problemeve”, etj. Në botën bankare, teknikat e reja të menaxhimit të rreziqeve dhe së fundmi kultura më e re e sistemeve të integruara të kontrollit të brendshëm, kërkojnë punonjës që zotërojnë njohuritë përkatëse në këto fusha, dhe për këtë arsye, Intesa Sanpaolo Bank Albania (ISPA) ka vendosur që t’i përgjigjet këtyre kërkesave, duke investuar te të sapo diplomuarit, duke i trajnuar ata në fushën specifike të punës. Vlen të theksohet gjithashtu fakti që shumë punëmarrës tërhiqen nga ideja e të punuarit jashtë vendit, por ne duhet të bëjmë të mundur që ata të kuptojnë se mundësitë që ofrohen në Shqipëri, në tërësi, janë gjithsesi më të larta se sa ato që ata mund të gjejnë jashtë vendit (këtu ata mund të jenë protagonistët e ndryshimit, ndërsa jashtë vendit do të jenë thjesht punonjës).

BANKIERI:

Në epokën e sotme të zhvillimit të vullshëm të bankëut digjital dhe fintech-save, si e parashikoni të ardhmen e ecurisë dhe zhvillimit të kapitalit human në sistemin bankar shqiptar?

Valbona Zeneli

Jetojmë në epokën e një lloji krejt të ri punonjësish dhe lidërshipi, i cili karakterizohet nga lehtësia dhe shpejtësia e një komunikimi digjital të paprecedent si dhe nga një dëshirë për të përqafuar mjedisin virtual të punës, ku pavarësia dhe fleksibiliteti në mënyrën e të punuarit po kërkojnë gjithnjë e më shumë nga kandidatët. Trysnia mbi Burimet Njerëzore për të masterizuar artin e menaxhimit të kapitalit njerëzor nuk ka qenë asnjëherë kaq e madhe. E ardhmja i takon mjedisit dhe eksperiencës digjitale të punës. Klientët po orientohen ndaj rrjeteve digjitale të komunikimit dhe bankat duhet t’i ndjekin. Problemi është që shumë banka në sistemin bankar shqiptar nuk janë ende gati; edhe në Europë institucionet e sistemit bankar kanë digjitalizuar 20 - 40 % të proceseve; 90 % e bankave Europiane investojnë më pak se 0.5% të shpenzimeve të tyre totale në digjitalizim. Si rezultat, shumica fokusohen ende në ofrimin dhe mundësimin e transaksioneve bazike për klientët. Kjo ndodh pasi

drejtuesit në sistemin bankar priren t’i vlerësojnë në një prizëm të ngushtë ndryshimet digjitale, si aplikacione që



Qëllimi ynë është të punësojmë jo vetëm dhe thjesht një staf cilësor, profesionist, por punonjës të përgjegjshëm, të besueshëm, në mënyrë që veprimtaria jonë të bëhet më efiçente, fitimprurëse dhe njëkohësisht shumë më e qëndrueshme në terma afatgjatë. Bankat ofrojnë pozicione të ndryshme pune në pjesën më të madhe për të diplomuarit dhe të specializuarit në menaxhim biznesi, financë, inxhinieri informatike, matematikë si edhe në shumë fusha të tjera. Banka jonë në mënyrë të vazhdueshme synon të gjejë kandidatë që jo vetëm zotërojnë aftësitë e kërkuara për të kryer detyrat specifike që do tu ngarkohen, por që janë gati të bëhen pjesë e një udhëtimi transformues për të paraprirë sfidat e sotme dhe për t’u përballur me sfidat që do të ofrojë e nesërmja.



nuk i nevojiten kësaj industrie. Disa banka justifikohen me çështjet e sigurisë dhe llogaritjes së rrezikut, krahasimisht

me industri të tjera. Megjithatë, ashtu si industria e linjave ajrore, e orientuar ndaj minimizimit të rrezikut dhe që ka automatizuar çdo aspekt të funksionimit të saj, edhe bankat mund të bëjnë të njëjtën gjë, duke konsideruar që këto përpjekje do të jenë të vlefshme, pavarësisht çmimit që kanë.

Ariana Tushi

Në këndvështrimin e digjitalizimit në vazhdim të industrisë bankare, kërkesa për më shumë aftësi digjitale në IT po rritet. Edukimi i punonjësve dhe i klientëve me shërbimin e bankëut digjital mbetet një prioritet i yni, duke pasqyruar transformimin e kulturës bankare në një botë digjitale. Në epokën e bankëut dhe mjedisit digjital të vendit të punës kërkohet një transformim rrënjësor në këtë aspekt e kjo nuk është vetëm çështje IT dhe sistemesh që lehtësojnë aksesin dhe shërbimin bankar për çdo klient, por një çështje që lidhet kryesisht me kapitalin human dhe Burimet Njerëzore. Nëpërmjet krijimit të një mjedisi që lejon punonjësit të zhvillojnë karrierën e tyre brenda funksioneve, si dhe zhvillimit të një organizate të orientuar nga shërbimi digjital i shkëlqyer ndaj klientëve, një bankë do të duhet të ketë një force pune më diverse dhe elastike, në terma të përshtatjes së roleve të reja, për të cilat ka gjithnjë nevojë të rekrutohen punonjës me një sërë aftësish shumë më të gjera, të shkathët, fleksibël ndaj ndryshimeve e të mësuar me sfida dhe produktivë. Si partner në formimin e studentëve, BKT nxit përditësimin e programeve/kurrikulave në përputhje me zhvillimet bankare, bankëut dixhital, përfshirë dhe të lëndëve të tilla mbi bankëut bashkëkohor dhe FinTech, të cilat do të rritin aftësitë profesionale e teknike të punonjësve të ardhshëm. Përvoja mjaft pozitive 9 vjeçare për mbështetjen e studimeve duale në Degën Menaxhim Bankar pranë Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktiken (FASTIP), të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës për edukimin/formimin e gjeneratës së re të punonjësve të BKT, një eksperiencë e akademisë gjermane të biznesit, e tregon këtë gjë. Sot ata përbejnë 9 % të stafit bankar dhe ndërkohë 44 studentë të tjerë janë në procesin e formimit/

edukimit si punonjës, duke integruar njohuritë akademike me kulturën organizative e etikën e punës, njohjen e produkteve/shërbimeve gjatë praktikave formuese në bankë. Vetë burimet njerëzore janë ndikuar nga digjitalizimi, si brenda bankës edhe jashtë saj, duke ju përshtatur zhvillimeve globale dhe prirjeve të gjeneratës së re. Jetësimi i sistemeve novatore SAP ERP (Employee Self Service ESS, Manager Self Service MSS, E-Recruitment, Performance Management, E-Learning, etj.) ka digjitalizuar burimet njerëzore, ofron zgjidhje komplekse, të automatizuara dhe të integruara, duke sjellë akses në HR të çdo punonjësi dhe drejtuesi për skuadrat e tyre.

Entela Zigori

Në ditët e sotme teknologjia po përparon shumë shpejt, duke ndikuar dhe ridisenuar jetët tona, mënyrën si ndërveprojmë, mënyrën e të menduarit apo mënyrën si e kryejmë punën tonë. Digjitalizimi pritet të përfshijë gjithnjë e më shumë sistemin bankar, duke rinovuar dhe përsosur më tej eksperiencën e punonjësve. Digjitalizimi dhe ndërveprimi me klienti thërret për modele të reja të shërbimit dhe për një evolucion të rëndësishëm në rolin e bankës. Kjo do të thotë se tashmë jemi përballë një mënyre të re të të bërit biznes!

Për të mbështetur këto objektiva, është e nevojshme të investohet në vijim për zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive digjitale të punonjësve e klientëve tanë.

Nisma të reja duhet të ndërmerren me qëllim ofrimin e trajnimeve ku veprimtaritë tradicionale plotësohen me metoda të reja të modeleve të punës, në mënyrë që të rritet aftësia e punonjësve për të shfrytëzuar dhe përdorur teknologjinë, e në të njëjtën kohë, për të ndihmuar klientët të familjarizohen me shërbimet digjitale të bankës. Kapitali human priret të jetë sa më afër ndryshimeve në teknologji; në të kundërt do të ishte i vështirë qëndrimi në tregun e punës.

Megjithatë, eksperiencia ka treguar se ndryshimet në teknologjinë e informacionit mirëpritur pozitivisht dhe pranohen në mënyrë të menjëhershme nga punonjësit tanë, pasi ato thjeshtojnë proceset e punës. Sektori bankar është gjithmonë i vëmendshëm dhe ndër të parët sektorë që përqafon e përshtatet me ndryshimet teknologjike.

BANKIERI:

Cili do të jetë roli i bankingut, si pjesë e tregut të punës?

Valbona Zeneli

Roli i bankingut, si pjesë e tregut të punës, fillon me formulimin dhe

implementimin e një vizioni të qartë për njerëzit. Në realitetin e sotëm digjital ky vizion bëhet edhe më i nevojshëm për të përshtatur rolet dhe funksionet e reja që punonjësit duhet të adaptojnë. Kjo kërkon dy mënyra: (i) përqasja ndaj një mënyre të re të menduarit dhe punuarit, si edhe (ii) zhvillimi i atyre aftësive që kërkojnë jetësimin e teknologjive të reja. Transformimi digjital do të zhvlerësojë rëndësinë e disa roleve, ndaj edhe shumë njerëz mund ta perceptojnë këtë si një kërcënim dhe do t'i bëjnë rezistencë ndryshimeve të këtij lloji. Gjithsesi, kjo duhet të orientojë vëmendjen e shumë të tjerëve ndaj krijimit të shumë mundësive të reja për zhvillim.

Në këtë realitet të ri është i nevojshëm një ndërgjegjësime më i lartë për mundësitë e reja teknike që ofrohen dhe ndikimi mbi proceset do të jetë një kusht paraprak në menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore. Talentet e reja do të jenë gjithnjë një stimul i rëndësishëm, por kërkesat për digjitalizim nevojiten të familjarizohen në një mënyrë të njëtrajtshe në të gjithë organizatë, si pjesë përbërëse e asaj çka është dhe ajo që kërkohet të arrihet. Digjitalizimi do të ndryshojë modelin tradicional të biznesit të bankingut retail, në disa raste rrënjësisht. Lajmi i keq është që ndryshimi do të ndodhë edhe nëse bankat nuk janë ende gati. Lajmi i mirë



është që ka shumë klientë të cilët presin që bankat ta përqafojnë këtë ndryshim.

Ariana Tushi

Mendoj që sistemi bankar do të vazhdojë të luajë të njëjtin rol modest, por elitar në tregun e punës në Shqipëri. Ai përbën sot vetëm 1.8% të tregut të punës në sektorin privat jo bujqësor. Rishpërndarja e punonjësve, ridisnjimi i roleve, zhvillimi i karrierës horizontale/vertikale të brendshme plot sfida, zhvillimi i aftësive dhe kompetencave të punonjësve, në përputhje me kohën e bankingut digjital, veçanërisht në fushën e teknologjisë, tele-puna dhe fleksibiliteti do të jenë aspekte me të cilat do të përballet sistemi bankar në të ardhmen. Gjithashtu, një fokus të veçantë strategjik do të ketë mbështetja e programeve të trajnimit për studentët praktikantë në të gjitha strukturat, për të krijuar grupe talentesh fleksibël për vazhdimësinë. Banka duhet të mbajë imazhin dinamik dhe novator, për të tërhequr dhe mbajtur në të ardhmen punonjësit që dëshirojnë, duke u ofruar mbështetje dhe sukses të vazhdueshëm që ajo të mbetet Punëdhënësi i Zgjedhur.

Entela Zigori

Bankat zotërojnë një potencial të madh për të kontribuar në mënyrë të dukshme në tregun e punës. Ato ndikojnë fuqishëm, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në krijimin e standardeve të mira të punës dhe e kanë ngritur edhe më shumë nivelin e standardeve që i përkasin kuadrit rregullator të çështjeve të punësimit. ISPA ka miratuar politika dhe rregullore që shtrihen përtej kërkesave të legjisllacionit shqiptar, e që sigurisht përmirësojnë edhe standardet e tregut të punës.

Kodi i Etikës, është “dokumenti i marrëdhënieve” që vendosen mes Bankës dhe gjithë grupeve të interesit që ndërveprojnë me të. Ky dokument përshkruan vlerat tek të cilat ne besojmë dhe ndaj të cilave angazhohemi duke vënë në dukje principet e sjelljes që rrjedhin nga konteksti i marrëdhënieve të vendosura me secilin prej grupeve të interesit. Gjatë viteve të fundit ne kemi mbështetur nisma të ndryshme, që lidhen me të drejtat e njeriut, si: punësimin e personave me aftësi të kufizuara (PAK),



Jetojmë në epokën e një lloji krejt të ri punonjësish dhe lidhshipi, i cili karakterizohet nga lehtësia dhe shpejtësia e një komunikimi digjital të paprecedent si dhe nga një dëshirë për të përqaftuar mjedisin virtual të punës, ku pavarësia dhe fleksibiliteti në mënyrën e të punuarit po kërkohen gjithnjë e më shumë nga kandidatët. Trysnia mbi Burimet Njerëzore për të masterizuar artin e menaxhimit të kapitalit njerëzor nuk ka qenë asnjëherë kaq e madhe. E ardhmja i takon mjedisit dhe eksperiencës digjitale të punës.



organizimin e kurseve të trajnimit për punonjësit tanë për ndërgjegjësimin mbi gjithë-përfshirjen dhe pjesëmarrjen në shoqëri të PAK-ve; vendosja e kanaleve të komunikimit me sindikatat, etj. ISPA beson në fuqizimin e grave. Pjesa më e madhe e Drejtuesve të Lartë Ekzekutivë të bankës përbëhet nga femra, me moshë mesatare nën 42 vjeç.

Në një këndvështrim më të gjerë, sistemi bankar në Shqipëri ndikon në mënyrë të dukshme tregun e punës edhe nëpërmjet financimit të nevojave të bizneseve të ndryshme. Në këtë kuadër, ISPA konsideron si prioritet strategjike programe të tilla si: (i) financimi i agrobizneseve, duke jetësuar një model të ri shërbimi të bazuar në nevojat dhe kërkesat e veçanta të kësaj industrie; (ii) zbatimi i plotë i programit “Gratë në biznes”, i krijuar me qëllimin për të mbështetur gratë sipërmarrëse në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Ballkanin Perëndimor. Në këtë kontekst, kontributi i bankave nuk kufizohet vetëm në gjenerimin e fitimeve për bizneset e financuara, por edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe mundësive të reja të punësimit, duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.



Cikli i ri i rritjes dhe faktori njerëzor vendas

Pagat e larta, formalizimi i plotë, qëndrueshmëria e sistemit dhe hapësirat për karrierë e bëjnë sektorin bankar një nga punëdhënësit më të lakmuar për profesionistët e aftë në ekonomi dhe financë.

Viti 2016 po konfirmohet si një vit i shëndoshjes së qëndrueshme të bilanceve të sistemit bankar në Shqipëri. Mbështetur në të dhënat më të fundit nga Banka e Shqipërisë, sistemi bankar e mbylli 10-mujorin me një fitim neto në vlerën e 8.3 miliardë lekëve. Treguesit e përfitueshmërisë janë pranë niveleve mesatare, me një ROE në masën 7.8% dhe ROA në nivelin 0.7%. Siç kishin paralajmëruar bankierët, përfitueshmëria është korrigjuar në rënie, për shkak të ngushtimit të marzhit të interesave, por edhe si rezultat i rikthimit të rritjes së huave me probleme. Pikërisht kjo rritje, sidomos në gjysmën e parë të vitit, mund të quhet zhvillimi më i papritur, por i shpjegueshëm, nëse kemi parasysh brishtësinë e përtëritjes ekonomike dhe problemet specifike që ekzistojnë me kuadrin ligjor dhe institucional të mbledhjes së detyrimeve.

Sistemi bankar nuk e ka ndalur asnjëherë rritjen (sipas AAB-së, në fund të tetorit totali i aktiveve u rrit 3.5% me bazë vjetore) dhe po priret të korrigjojë ato dobësi të evidentuara në vitet e krizës, si: përqendrimi i lartë i rrezikut në korporata, apo grupe të veçanta, si dhe ekspozimi i lartë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Tani fokusi është te diversifikimi dhe segmenti retail. Sipas Bankës së Shqipërisë, në fund të shtatorit portofoli i huas për individë ishte në rritje vjetore me 8.5%, ndërsa stoku i huas në Lek u rrit me 8.2%, krahasuar me një vit më parë. Përmirësimi i ekonomisë reale me shumë të ngjarë do të ndihmojë rritjen e veprimtarisë huadhënëse. Nga ana tjetër,

nisma ligjore për lehtësimin e ekzekutimit të kolateralit tregon se ka një vullnet për t'i përmirësuar më shumë këto procese. Momenti më delikat duket se ka kaluar dhe sistemi bankar me shumë të ngjarë do të ndodhet para një cikli të rritjes. Një rritje e re e shëndetshme e sektorit bankar është, së pari një çështje e strategjive të duhura dhe njerëzve të duhur. Kriza e gjatë, nga një sprovë, tashmë është kthyer në një thesar të çmuar përvojë për bankierët, për të kuptuar gabimet që mund të jenë bërë në të shkuarën. Nga ana tjetër, zhvillimi i shpejtë i sistemit bankar privat në Shqipëri ka prodhuar një kapital të çmuar njerëzor, një ekip prej disa mijëra profesionistësh të sektorit bankar, që kanë dhënë kontribut dhe kanë fituar eksperiencë në vite.

Më shumë pushtet për drejtuesit vendas

Në konferencën e qershorit 2016 lidhur me qeverisjen e korporatave në sektorin financiar, një nga gjetjet kryesore të Bankës së Shqipërisë ishte se strategjitë e biznesit të bankave të huaja në Shqipëri përcaktohen kryesisht nga grupet bankare zotëruese, ndërsa ndikimi strukturave drejtuese lokale në këtë drejtim është i dobët. Ky fenomen, veçanërisht në vitet e krizës, ka pasur edhe arsye objektive, po të kemi parasysh sfidat serioze me të cilat janë përballur shumica e grupeve bankare të eurozonës dhe nevojës për konsolidim në nivel grupi, që ka kushtëzuar kufizimin e mëtejshëm të autonomisë së filialeve në tregjet e Europës Qendrore dhe Lindore. Sigurisht, do gabonim po të pohojmë se bankat me kapital të huaj nuk kanë besim te menaxherët shqiptarë; nga 16 banka

tregtare, pesë prej tyre kanë në krye një drejtor të përgjithshëm shqiptar dhe tre prej tyre, drejtojnë banka me kapital të huaj. Nëse i referohemi numrit të CEO-ve shqiptarë vetëkuptohet se çështja nuk qëndron edhe aq me shtetësinë e menaxherëve, por në vlerësimin e njerëzve që e njohin mirë tregun. Në Shqipëri ka edhe drejtues të huaj bankash që punojnë këtu prej shumë vitesh, disa prej më shumë se një dekadë. Gjatë viteve të fundit, bankat me rritjen më të madhe kanë qenë pikërisht ato që kanë pasur baza më të forta lokale, përfshi këtu dhe rëndësinë e menaxherëve vendas në vendimmarrjet strategjike. Sistemi financiar dhe sektori bankar kanë sot mundësinë të punësojnë burimet njerëzore më cilësore, në profilet e kërkuara nga kjo veprimtari kryesisht për një fakt të thjeshtë: pagat në sektorin financiar janë më të lartat në ekonomi (duke përfshirë këtu pagesat e organizatave ndërkombëtare). Sipas INSTAT, në vitin 2015 paga mesatare bruto në sektorin financiar ishte 95,527 lekë, në rritje me afro 9% krahasuar me vitin 2014. Pagat e larta, formalizimi i plotë, qëndrueshmëria e sistemit dhe hapësirat për karrierë e bëjnë sektorin bankar një nga punëdhënësit më të lakmuar për profesionistët e aftë në ekonomi dhe financë. Stimulimi i aftësive dhe ambicieve të këtyre profesionistëve do të jenë padyshim faktor i rëndësishëm në suksesin e një cikli të ri rritjeje të sistemit bankar në Shqipëri.

Ersuin Shehu
Gazetar

OFERTAT MË TË MIRA DHE KONKURUESE
NË TREGUN BANKAR!



CBA JU OFRON:

Depozita, Ilogari rrjedhëse dhe me afat, transferta parash, garanci bankare,
shkëmbime dhe të gjitha shërbimet tradicionale bankare.

Adresa: Rr. "Perlat Rexhepi",
Ndërtesa Administrative " AL-KHARAFI
(pranë Fuktetit Juridik)
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42 272168/66; Fax +355 42 272162
E-mail: creditbkalb@icc-al.org
creditcba@icc-al.org

Sheraton Tirana Hotel
Shopping Plaza
Tel: +355 42 2255372/388/368/346
Fax: +355 42 255340

Hotel "Butrinti" Sarandë
Tel: +355 85 225405



Dr. Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE, AAB

Viti 2016 ndërron fletë, duke përforcuar ndjesinë dhe bindjen se mjedisi për banking ka ndryshuar dhe ndryshime më të mëdha do të materializohen në të ardhmen. Ekspertët dhe politikëbërësit gjithnjë e më shpesh kanë përdorur shprehjen e vjetër kineze: “jetojmë në një kohë interesante”, për të përmbledhur faktorët që kanë kushtëzuar ndryshimet në banking. Faktorë si: rënia globale e rritjes ekonomike, kriza e stërzgatur e borxheve dhe ajo financiare, Brexit, tensionet gjeopolitike në Europën Lindore dhe Lindjen e Mesme, mjedisi me norma interesi thuhet zero, ndryshimet strukturore për shkak të digjitalizimit, mbi-rregullimet bankare (Bazel III dhe IV në diskutim), perceptimet negative për bankat për shkak të krizës financiare, etj., kanë vënë në pikëpyetje shumë anë të kryerjes së veprimtarisë bankare. Sot po flitet gjithnjë e më shumë për modele të bankingut që mund të jenë realitet i gjerë pas vitit 2020.

Bankat: Brand-i më i mirë në Shqipëri



Drejtimesit e institucioneve financiare dhe bankave përballen ditët e sotme pak a shumë me të njëjtat sfida, por në një treg ende të pamaturuar në shit-blerjen e produkteve bankare siç është Shqipëria, sfida më e madhe është forca e shitjes, e cila ofron produkte tradicionale dhe inovative.



Por, nëse agjenda në vendet e zhvilluara është përqendruar në mbi-rregullimin bankar dhe modelet e së ardhmes, në vendet e tjera këto përcillen të përziera me problematikën vendore. Nëse në vendet e zhvilluara ndryshimi i bankingut është një detyrim ndaj publikut dhe ekonomisë, për shkak të krijimit të krizës, në



Rolin e ndërmjetësit financiar bankat e kryejnë edhe kur dërgojnë paratë jashtë. Kjo nuk është ndonjë parregullsi e zakonit bankar, apo shkelje e veprimtarisë ligjore të bankave. Bankat janë të lejuara të japin e të marrin; të japin në tregun ndër-bankar, kombëtar apo ndërkombëtar, tepricat e tyre dhe të huazojnë në momentin kur kanë nevojë për fonde. Ky është ndërmjetësim financiar.



Shqipëri bankat nuk krijuan asnjë krizë. Përkundrazi, bankave në Shqipëri iu desh të përballeshin me efektet e krizës. Fakti që për shumë vite dërgesat e emigrantëve ishin faktor i modelit tonë të zhvillimit, me hyrjen në krizë të vendeve fqinje rënia e tyre frenoi konsumin dhe shpenzimet, duke pakësuar anën e kërkesës. Bizneset u ndeshën me vështirësi të realizimit të projekteve, për shkak të ndryshimit të konjunkturave të tregut, çmimeve, kërkesës, etj. Për pasojë, problemi më i madh i krijuar për bankat ishin huat me probleme, që kulmojnë me 25% në shtator 2014 dhe aktualisht mbi 21%. Ky nivel, i shoqëruar me disa ngjarje sporadike të rrezikut operacional në disa degë bankash, me disa sulme grabitjesh të cash-it gjatë transportit dhe i kulmuar me vjedhjen e parave në Bankën e Shqipërisë, duket sikur u bënë bashkë për të cenuar reputacionin e bankave, të pranuar si pararoja e ekonomisë sonë. Si ekonomi ne duhet të krenohemi me bankat sepse:

- Mjetet gjithsej të industrisë bankare më 30 shtator 2016 arritën 1,400 miliardë lekë, pothuaj sa vlera e PPB-së. Ndërkohë, kapitali i investuar

në industrinë bankare është 173 miliardë lekë.

- Bankat kanë të punësuar rreth 6 mijë punonjës, njerëz të talentuar e të kualifikuar, të cilët dinë të përballen profesionalisht me vështirësitë dhe të përcjellin pa eufori sukseset. Vetëm në vitin 2015 Shoqata Shqiptare e Bankave organizoi 21 trajnime, ku u trajnuan 257 punonjës. Sektori bankar ka furnizuar me staf sektorët e tjerë të ekonomisë, privat dhe publik.
- Bankat kanë udhëheqjen korporative (corporate governance) në nivelin më të lartë të zhvilluar në vend (asambleja, këshilli drejtues, bordi ekzekutiv, komitete të ndryshme, strukturë organizative të detajuara, përshkrimet e vendit të punës, kodin e etikës, etj.).
- Bankat kanë mbështetur me hua rritjen e ekonomisë. Aktualisht, janë rreth 600 miliardë lekë hua në ekonomi, të cilat janë pak më shumë se gjysma e depozitave.
- Qytetarët i kanë besuar kursimet e tyre nëpër banka, duke mos e vënë në diskutim sigurinë e tyre. Aktualisht janë mbi 1,100 miliardë lekë depozita në sektorin bankar. Në mungesë të larmisë së alternativave të tjera të përdorimit të kursimeve, lidhja qytetar-bankë në vite është bërë më e fortë.
- Bankat janë nga shoqëritë më të rregullta në pagimin e detyrimeve tatimore. Bankat paguajnë tatim mbi fitimin, mbi të ardhurat personale, kontributet për sigurimet shoqërore dhe kujdesin shëndetësor, deklarojnë çdo të punësuar, kanë kontrata të rregullta pune, zbatojnë kërkesat për rrezikun në vendin e punës, duke qenë në pararojë të transparencës dhe korrektësisë.
- Bankat shpenzojnë çdo vit për përgjegjësinë korporative. Vetëm në vitin 2015 janë shpenzuar mbi 1.3 milionë euro për lidhjen me komunitetin, për përmirësimin e kushteve të tyre, artin, kulturën, mjedisin, të cilat tani përmbledhen në Strategjinë e Zhvillimit të

Qëndrueshëm Global.

- Bankat kanë investuar shumë në teknologji. Për periudhën 2011 – 2015 sektori bankar investoi rreth 65 milionë euro për zhvillimin e shërbimeve dhe teknologjisë së informacionit. Për vitin 2016 priten rreth 16 milionë euro investime. Shumë produkte të reja të ofruara në treg janë rezultat i zhvillimit të teknologjisë. Ndërkohë, që vëmendje të posaçme po i kushtojnë sigurisë së informacionit.
- Për periudhën 2008 - 2015 bankat investuan rreth 54 miliardë lekë kapital shtesë, ndërkohë që për të njëjtën periudhë fitimi i sektorit ka qenë vetëm 48 miliardë lekë. Pra, parë më gjerë se një vit, sektori bankar paraqitet me kontribut neto, që do të thotë se janë kryer investime të huaja shtesë, për të përballuar humbjet nga huat me probleme dhe kërkesat rregullatore. Kthimi mbi kapitalin dhe kthimi mbi mjetet gjithsej janë respektivisht 13.8% dhe 1.2% për vitin 2015.

Pra, bankat janë një e mirë me të cilën duhet të krenohemi si ekonomi. Ai është brand-i ynë më i mirë: solid, i qëndrueshëm, mbështetës i fuqishëm i ekonomisë, garanci e stabilitetit dhe sigurisë financiare në vend, me rreth 92% të mjeteve të industrisë financiare. Pavarësisht humbjeve financiare për periudhën pas krizës, mjedisit me interesa zero, që ka zvogëluar shumë mundësitë për fitim, rrezikut të shtuar (sulmet ndaj sporteleve dhe eskortave të transportit të cash-it), rritjes ekonomike të ulët, edhe pse në prirje rritëse, nivelit të huave me probleme, mangësive të sistemit të drejtësisë në ekzekutimin e kontratave, etj., bankat janë të mirë-kapitalizuara, likuide, të sigurta dhe në rolin e tyre të ndërmjetësit financiar.

Rolin e ndërmjetësit financiar bankat e kryejnë edhe kur dërgojnë paratë jashtë. Kjo nuk është ndonjë parregullsi e zakonit bankar, apo shkelje e veprimtarisë ligjore të bankave. Bankat janë të lejuara të japin e të marrin; të japin në tregun ndër-

bankar, kombëtar apo ndërkombëtar, tepricat e tyre dhe të huazojnë në momentin kur kanë nevojë për fonde. Ky është ndërmjetësim financiar. Në kushtet e mungesës së kërkesës për hua, bankat nuk mund të mbajnë mjete të papërdorura, për më tepër kur bëhet fjalë për monedha të huaja, të cilat edhe fizikisht nuk ke ku i mban.

Gjetja e rrugëve të reja për të siguruar fitim është një sfidë e sektorit bankar dhe jo vetëm në Shqipëri. Perceptimi se bankat "janë të mbuluara në para", se fitojnë shumë si asnjë sektor tjetër, janë të gabuara dhe të pambështetura në të dhënat zyrtare. Do të ishte shumë mirë që bankat të ishin me fitime të tilla, se do të paguanin më shumë tatim për buxhetin e shtetit dhe do të siguronin më shumë hapësirë për ulje kostosh, por fakti nuk është i tillë. Fitimi paraparak i 9 muorit 2016 është vetëm 6.5 miliardë lekë, me një tregues të kthimit mbi kapitalin me vetëm 6.8 për qind. Kushdo mund të bëjë krahasimin e këtij treguesi me sektorët e tjerë për të kuptuar se sa fitim sigurohet nga 1 lekë investim. Në këtë mënyrë do të bjerë edhe iluzioni se bankat "janë të mbuluara në para".



Bankat janë institucione besimi dhe si të tilla çdo ngjarje bën lajm, por nuk mund të jenë të besueshme si lajme sulmet që bëhen ndaj përgjegjësisë së bankave për treguesin e lartë të huave me probleme. Në shpjegimin e kësaj situatë shpesh ka populizëm dhe demagogji. Këtu anashkalohet thelbi i marrëdhënies huadhënës – debitor: banka të ka dhënë hua dhe duhet të marrë mbrapsht paratë e dhëna.





Bankat janë institucione besimi dhe si të tilla çdo ngjarje bën lajm, por nuk mund të jenë të besueshme si lajme sulmet që bëhen ndaj përgjegjësive së bankave për treguesin e lartë të huave me probleme. Në shpjegimin e kësaj situatë shpesh ka populizëm dhe demagogji. Këtu anashkalohet thelbi i marrëdhënies huadhënës - debitor: banka të ka dhënë hua dhe duhet të marrë mbrapsht paratë e dhëna. Marrëdhënia është ligjore dhe rreziku i huadhënies është i mbrojtur edhe me kolateral, si opsion rezervë, në rast të dështimit të debitorit në të ardhurat e mjaftueshme për të ripaguar huan. Kjo është thelbësore. Nëse mund të ketë raste të mungesës së sjelljes korrekte nga ndonjë punonjës, etj., këto janë çështje operationale të dënueshme, por që nuk e deformojnë thelbin e marrëdhënies kreditor-debitor. Për më tepër, paratë që jepen hua janë depozita të qytetarëve. Me huan nuk bëhen politika sociale, prandaj dhe shoqëria

duhet të jetë më e ndërgjegjësuar për të dënuar ata që nuk paguajnë huan. Në një marrëdhënie huaje banka nuk është e keqja, ajo është zgjidhja, por kjo zgjidhje duhet shoqëruar me marrje përsipër të përgjegjësive nga huamarrësi.

Mospagimi i huas ka kosto për huadhënien në vazhdimësi. Sa më i lartë rreziku i moskthimit të huas dhe sa më i vështirë procesi i ekzekutimit të kolateralit, aq më e lartë do të jetë norma e interesit për huan. Gjatë procesit të ekzekutimit të kontratës së huas për shitjen e kolateralit, që nga momenti i nxjerrjes së urdhrimit të ekzekutimit, bankat nuk janë më pjesë e procesit të shitjes, por janë pala e interesuar në vjeljen e të ardhurave. Bankat nuk kanë të bëjnë as me vlerësimin e kolateralit për shitje, as me procesin e ankandit, as me mënyrën e drejtimit të këtij procesi. Prandaj është e tepërt të akuzosh bankën në këtë proces. Kjo ngjan me transportin

e vlerave monetare, të cilin bankat e kontraktjnë me shoqëri të licencuara për këtë lloj veprimtarie. Bankat nuk janë përgjegjëse për transportimin e vlerave monetare; shoqëritë private të sigurimit fizik janë përgjegjëse, por kur ndodh një ngjarje e para tregohet banka si përgjegjëse. Në fakt, ligjërisht nuk është kështu.

Shpesh mos kuptimi i gjërave siç ndodhin realisht dhe siç janë rregulluar ligjërisht, lë shkas për interpretime individuale e subjektive. Në mungesë të fjalës së ekspertit dhe profesionistit, komentet nga joprofesionistë krijojnë paqartësi dhe cenojnë imazhin e bankave. Në këtë aspekt, industria bankare mund të bëjë më shumë, si për edukimin financiar të popullsisë, ashtu edhe të përdorimit të ekspertëve të saj për të shpjeguar fenomene, ngjarje apo situata të caktuara, që kanë lidhje drejtpërdrejt, ose tërthorazi, me bankat. Koha dëshmon se tregu ka nevojë më shumë për fjalën e profesionistëve.



SHORTEU PROMOCIONAL “KURSE DHE FITO”



Duke filluar nga data 31 Tetor 2016 deri më 31 Maj 2017, të gjithë ju që do të hapni një depozitë me afat minimal 25 muaj, automatikisht do të bëheni pjesë e shorteut “Kurse dhe Fito” për një udhëtim në Disneyland Paris me familjen tuaj.

Kushtet e pjesëmarrjes:

- ▶ Të hapësh një depozitë të re duke filluar nga 25 muaj.
- ▶ Përfshihen edhe klientët që rinovojnë depozitë gjithashtu duke filluar nga 25 muaj.

 **CREDINS bank**
Ne flasim gjuhën tuaj!



Albina HASANAJ

Përgjegjëse e Sektorit Juridik
BANKA SOCIETE GENERALE
ALBANIA

Gjatë vitit 2016 ndodhën disa ndryshime të rëndësishme në legjislacionin shqiptar, që lidhen kryesisht me procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm, falimentin si dhe me ri-sjelljen e disa garancive, të cilat me ndryshimet e ndodhura në vitin 2013 në ligjin “Për barrët sigurorese” ishin shfuqizuar.

Përmirësimi i legjislacionit erdhi si nevojë e zbutjes së nivelit të huave me probleme, nismë kjo e qeverisë shqiptare, me mbështetjen e Bankës Botërore, si dhe me angazhimin e Shoqatës Shqiptare të Bankave. Qëllimi i këtyre ndryshimeve ishte përshpejtimi i ndjeshëm në procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, duke pasur parasysh kategorizimin që i ka bërë ligjvënësi akteve të dhënies së Kredisë Bankare, duke i klasifikuar “tituj ekzekutiv”, sipas nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile. Në këto kushte, përmirësimi i nenit 511, duke parashikuar që lëshimi i Urdhrit të Ekzekutimit

Ekzekutimi i detyrueshëm i kolateralit

disa ndryshime të rëndësishme



Miratimi i ligjit nr. 114/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, ka përmirësuar dukshëm kuadrin ligjor nëpërmjet disa parashikimeve për unifikimin e praktikave të ekzekutimit të detyrueshëm.



të bëhet pa praninë e palëve, sjell një përshpejtim të procesit për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit. Në ndryshim nga sa më parë, ku gjykata caktonte një seancë gjyqësore, aktualisht ajo duhet të veprojë bazuar në vlerësimin e akteve, dorëzuar së bashku me kërkesën e Kreditorit për lëshim Urdhër Ekzekutimi.



Duke e konsideruar Ekzekutimin e Detyrueshëm si një proces që duhet të ketë efikasitet, por edhe shpejtësi, rishikimi i afateve procedurale është një garanci juridike më shumë për Debitorin, Kreditorin, por edhe për çdo palë të tretë që përfshihet në këtë proces.



Në propozimin e parë të ligjberësit, projektligji parashikonte që në lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit të ishte palë edhe Debitori, si dhe në vlerësim të Gjykatës të thirrej një ekspert për llogaritjen e detyrimit. Në fakt, gjatë zhvillimeve në seancat në Komisionin e

Ligjeve, diskutimi i Shoqatës Shqiptare të Bankave u fokusua që ky projektligj do të kthente mbropa në kohë mbi vet nocionin ligjor “të titullit të ekzekutimit”, si dhe të “urdhrit të ekzekutimit”, ashtu sikurse do të cenonte rëndë pozitën e Kreditorit, pasi sipas këtij projektligji procesi për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit po trajtohej si një çështje me palë ndër-gjyqësore. Me Vendimin nr.39, datë 16.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese janë parashtruar argumente shterues pse aktet për dhënie e Kredive Bankare duhet të kenë një trajtim të posaçëm nga ligjvënësi, për shkak të një qëllimi të përligjur dhe të justifikuar në këndvështrimin kushtetues, atë “të interesit publik”, duke pasur parasysh ndikimin mbi ekonominë e vendit dhe stabilitetin ekonomik. Nga ana tjetër, Debitori ka mjaftueshëm mjete ligjore për të mbrojtur pozitën e tij dhe nuk cenohet aspak parimi i barazisë para ligjit, apo parimi i kontradiktoritetit në gjykim, kjo e drejtë themelore realizohet nëpërmjet zbatimit të nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile, i cili i jep Debitorit të drejtën që të disponojë me një kërkesë padi garantimin e të drejtave që i janë cënuar, nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor.

Në këtë kuadër miratimi i ligjit nr. 114/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8116, datë 29.3.1996,

“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, ka përmirësuar dukshëm kuadrin ligjor nëpërmjet disa parashikimeve për unifikimin e praktikave të ekzekutimit të detyrueshëm. Në këtë frymë, në nenin 511 është bërë përcaktimi i modaliteteve të Urdhrit të Ekzekutimit, si dhe normimi i masës së kamatës ligjore të zbatueshme. Nëpërmjet zbatimit të kësaj norme, e cila është në linjë edhe me nenin 450 të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë, është synuar mënjanimi i praktikave të ndryshme gjyqësore, lidhur me lëshimin dhe përmbajtjen e Urdhrit të Ekzekutimit, apo qëndrimeve të Përmbarrimit Gjyqësor në lidhje me masën e detyrimit, objekt ekzekutimi. Gjithashtu, ndryshimet në këtë nen mënjanojnë praktikatat e deritanishme, ku kushtet penale për pagesë vonese ishin subjekt i termave kontraktuale, ndërsa sot kemi një barazi aplikimi për të gjithë titujt ekzekutiv të akteve të dhënies së Kredive Bankare. Kjo normë unifikuese sigurisht që nuk cenon parimin kontraktual "vullneti i lirë i palëve", kushte të cilat do të aplikohen deri në momentin e lëshimit të Urdhrit të Ekzekutimit.

Gjatë rrugës do të shtrohen çështje dhe do të ketë qëndrime që do të duhet të unifikohen nga Gjykata, si p.sh.: përcaktimi i momentit të "pagesës me vonesë", pra do t'i referohet afateve të përcaktuara në kontratat midis palëve, apo afateve të lidhura me momentin e lëshimit të Urdhrit të Ekzekutimit.

Një risi në këtë ligj janë edhe ndryshimet në nenin 525 i cili njeh dhe legjitimon tarifën e suksesit si një drejtë për t'u zbatuar nga Kreditori, të formalizuar në marrëveshje me Përmbarruesin Gjyqësor për një proces të suksesshëm ekzekutimi, e përshkallëzuar

kjo edhe në ligjin material për Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Privat dhe Shtetëror. Sigurisht që, ky nocion nuk duhet të ndikojë mbi ecurinë e veprimtarisë së Përmbarruesit Gjyqësor, i cili udhëhiqet nga parimet e Kodit të Procedurës Civile mbi ekzekutimin e detyrueshëm që rregullon veprimet përmbarrimore dhe afatet procedurale. Përmbarruesi Gjyqësor, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, është i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv dhe sigurisht që nuk duhet të kufizohet në ushtrimin e detyrës së tij vetëm në kryerjen e veprimeve formale, ashtu sikurse janë të veshur edhe me fuqinë për të vendosur sanksione, në rast se Debitori apo Palë të Treta bëhen pengesë apo nuk përmbushin urdhrin e Përmbarruesit Gjyqësor (Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 13, datë 21.03.2012). Pra, gjithë dispozitat ligjore imponojnë një angazhim dhe veprime konkrete të Përmbarruesit Gjyqësor në përmbushjen e një vendimi gjyqësor, një drejtë e njohur nga Gjykata.

Në kuadër të unifikimit, një zhvillim i rëndësishëm është edhe neni 564, i cili parashikon përcaktimin e metodologjisë për vlerësimin e sendit të sekuestruar, nëpërmjet akteve normative të Këshillit të Ministrave, duke evituar subjektivizmat në proceset e vlerësimit të pronave të sekuestruara. Po kështu, caktimi i një ankandi të tretë, kjo sipas ndryshimeve të sjella me Nenin 577 të Kodit të Procedurës Civile, u jep gjithë Kreditorëve një mundësi më shumë që të mbledhin huat e tyre nëpërmjet grumbullimit të të hollave si mjete të lira financiare për tu riinvestuar në sistemin e kreditimit.

Në tërësi, duke e konsideruar

Ekzekutimin e Detyrueshëm si një proces që duhet të ketë efikasitet, por edhe shpejtësi, rishikimi i afateve procedurale është një garanci juridike më shumë për Debitorin, Kreditorin, por edhe për çdo palë të tretë që përfshihet në këtë proces. Kështu përcaktimi i afatit procedural 30 ditor nga marrja dijeni për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, parashikuar në nenin 609 të rishikuar, brenda së cilës Debitori mund të ushtrojë të drejtën për të paraqitur kërkesë-padi mbi Pavlefshmërinë e Titullit Ekzekutiv, ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël, ose është shuar më pas, është një ndryshim themelor. Nëpërmjet këtij ndryshimi, ligjvënësi ka synuar të mënjanojë praktika të tilla, ku edhe pse Debitorit i është komunikuar fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm, ky i fundit ka ushtruar të drejtën sipas nenit 609, pasi kanë përfunduar të gjithë veprimet përmbarrimore. Pra, mungesa e një afati parashkrimi mbi ushtrimin e të drejtës së padisë, ka bërë që Gjykata t'i referohet afatit të përgjithshëm 10 vjeçar si afat parashkrimi, duke krijuar një pasiguri juridike, pasi në praktikën e mëparshme jo rrallë ndodhte që sendi i sekuestruar mund të kishte kaluar në pronësi të një pale të tretë, duke i cenuar këtij të fundit të drejtën e pronësisë.

Po në frymë të afateve procedurale, neni 610 i riformuluar, sjell afate të shkurtra, brenda të cilave Gjykatat duhet të shqyrtojnë kërkesat, apo ankimet, për veprimet përmbarrimore, apo shtrirjen e efekteve të vendimeve të pezullimit.

Në përfundim, mund të themi që këto ndryshime legjislative përmbushin qëllimin parësor për krijimin e masave lehtësuese ligjore për rikuperimin e shpejtë dhe efikas të Kredive Bankare.





Irida HUTA

Drejtoresh e Zhvillimit të Biznesit
PAYLINK

Shqipëria është ende në hapat e para të kalimit nga pagesa cash në pagesat elektronike. Ky biznes në kushtet aktuale nevojitet të analizohet në aspektin: (i) Karta të emetuara/aktive/të përdorura (Cards); (ii) Vende/Tregtarë ku pranohen këto karta (Acceptance; ATM & POS).

Këto faktorë kanë një lidhje të ndërsjelltë dhe nuk konceptohen pa qenë të lidhur ngushtë me njëri - tjetrin. Në një kohë kur tregu gjithnjë e më tepër po pranon pagesat elektronike, institucionet financiare po promovojnë fuqishëm kartat, duke u kthyer kështu në një realitet në vend prej të paktën 10 vitesh. Bazuar në statistikat e fundit, pagesat elektronike në Shqipëri kanë pësuar rritje gjatë vitit 2015, pavarësisht se mbeten ende në nivel të ulët. Në Europë pagesat elektronike zënë mesatarisht më shumë se 50% të sektorit të pagesave. Në këtë fushë duhet që shoqëria shqiptare të bëjë përpjekje serioze për përdorimin e pagesave elektronike në një shkallë më

Pagesa me Karta

Revolucioni Digjital për Blerjet dhe Huamarrjen



“Ekonomia e shkallës” është ajo që justifikon shpenzimet në këtë fushë biznesi; sa më shumë rritet numri i transaksioneve me kartat aq më pak paguajnë bankat të zotëruesit e skemave dhe aq më shumë rriten në krahun tjetër fitimet e pritshme nga produktet dhe shërbimet e ofruara.



të gjerë. Studimet tregojnë se një shtet mund të kursejë 2 – 5% të PBB-së, nëse kalon në pagesat elektronike në nivele të larta (mbi 80% të të gjitha pagesave). Një sistem pagesash elektronik nuk është vetëm me eficient në kosto, por gjithashtu prodhon transparencë dhe mekanizëm të fortë monitorimi për sistemin e taksave. Në fakt, bizneset duhet të paguajnë



Studimet tregojnë se një shtet mund të kursejë 2 – 5% të PBB-së, nëse kalon në pagesat elektronike në nivele të larta (mbi 80% të të gjitha pagesave). Një sistem pagesash elektronik nuk është vetëm me eficient në kosto, por gjithashtu prodhon transparencë dhe mekanizëm të fortë monitorimi për sistemin e taksave.



për transaksionin elektronik një kosto prej 1.5 – 2.5% të shumës së veprimt/ transaksionit të bankat. Kjo është një

arsye për të cilën bizneset hezitojnë të përdorin aparatet e kartave elektronike. Gjithsesi, vlen për t'u përmendur fakti se, cash-i ka kosto të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, siç janë: (a) kosto e transportit; (b) kosto e sigurimit (c) kosto operacionale e numërimit/përputhshmërisë, të cilat nëse bëhet një llogari e thjeshtë do t'i kushtojë biznesit një vlerë financiare më të lartë. Në tregun vendas mbetet ende sfida se si mund të bëhet e mundur që bizneset, pavarësisht nga industria apo produktet e ofruara, të pranojnë përdorimin masiv të kartave elektronike.

Për të kuptuar çfarë mungon aktualisht në tregun vendas shtrohen disa pyetje, sa më poshtë:

1. A është investuar mjaftueshëm për të mbështetur këtë veprimtari nga bankat në Shqipëri?
2. A është edukuar tregu i brendshëm për të përdorur këto kanale alternative pagesash, kundrejt një konkurrence të shëndetshme? A shoqërohet emetimi i kartave me një përdorim masiv të tyre?
3. A ka një legjislacion të përshtatshëm dhe çfarë mund të ndihmonte në këtë fushë?
4. A ka një nismë vendore, apo qeveritare, për të përfaqësuar, ose promovuar këto investime në vend?

Të gjithë biem dakord se “ekonomia e shkallës” është ajo që justifikon shpenzimet në këtë fushë biznesi; sa më shumë rritet numri i transaksioneve me kartat aq më pak paguajnë bankat te zotëruesit e skemave dhe aq më shumë rriten në krahun tjetër fitimet e pritshme nga produktet dhe shërbimet e ofruara.

Nëse analizojmë sistemin bankar dhe shoqëritë mbështetëse të kësaj veprimtarie në tregun vendas mund të themi me siguri të madhe që jemi të ngjashëm me vendet e rajonit, por edhe më gjerë, qoftë nga pikëpamja e teknologjisë/produkteve të përparuara, ashtu edhe në drejtim të sigurisë së ofruar. Në Shqipëri janë të pranishme shoqëri prestigjioze ndërkombëtare, si dhe shoqëri vendase, që ofrojnë shërbime cilësore me kosto operative eficiente, si p.sh.: shoqëria PayLink. Kjo shoqëri është e pranishme në tregun vendas për të mbështetur institucionet financiare në shërbimet e personalizimit të kartave, përpunimit të transaksioneve me kartat, krijimin e një skeme lokale, ku mund të kanalizohet një pjesë e segmenteve bankare, duke i ofruar një produkt të përshtatshëm për tregun vendas, kundrejt një kostoje më të lirë, pastrim dhe rregullim llogarish për pagesat ndërbankare, shërbime inovatore të zbatuara me sukses, si: kartat pa kontakt (contactless), pagesat online, pagesat e shërbimeve publike nëpërmjet ATM/POS, kartat dhuratë (gift cards), kartat e parapaguara, kartat virtuale, si dhe shumë produkte të tjera. Gjithashtu, ajo ofron mundësinë e hedhjes në treg të një skeme të përbashkët për pikat e shitjes (POS), duke bërë të mundur uljen e kostove ndjeshëm për këtë linjë biznesi. Nëse do të marrim një shembull të thjeshtë për të kuptuar p.sh. ndikimin e unifikimit të skemës së POS-ve, do të qartësohej fakti se, nëse një POS kushton X euro/ muaj për një bankë, kjo kosto do të pjesëtohet me x1 apo më shumë, nëse do të ndahet midis bankave. Pikërisht ulja e kostove të POS-eve apo kostove të mirëmbajtjes nga njëra anë do të lehtësonte bankat kundrejt investimeve të kryera (ROI më të shpejtë) dhe nga ana tjetër do të nxiste skemat nxitëse për konsumatorët vendas.

Shembuj për tu ndjekur ka shumë,

megjithatë, këtu mund të përmenden disa prej tyre, si vijojnë:

Unifikimi i skemës së pranimit të kartave në pikat e shitjes. Kjo do të ulë kostot e investimit, kostot operative, do të shtyjë drejt një konkurrence të shëndetshme dhe bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet bankave lokale në këtë biznes. Këtu mund të përmendim zbatimin e një skeme lokale interchange, e aplikuar suksesshëm në mbarë botën.

Investime / Financime Qeveritare: Meksika, e cila nëpërmjet projektit “FIMPE” arriti të rrisë përdorimin e pagesave elektronike nëpër dyqane me 170% në periudhën 2003-2006, duke qënë në të njëjtën fazë zhvillimi në këtë fushë ku ndodhet aktualisht Shqipëria. Ata përdorën disa programe nxitëse, si: qeveria investoi vet në pajisjet e përdorimit të kartave për dyqanet (POS terminals) dhe organizoi fushata informuese, në mënyrë që të krijohej një rrjet i transaksioneve elektronike, që do të ndihmonte në mbledhjen e taksave, por njëkohësisht do të lehtësonte klientët dhe bizneset. Në të njëjtën mënyrë, në Bullgari bankat dhe ofruesit e pagesave elektronike, gjatë viteve të fundit, kanë bashkëpunuar për të përmirësuar përhapjen e tyre. Praktika të tjera përfshijnë lehtësime taksash, ose zbutje të nivelit të taksave për bizneset që pranojnë pagesat elektronike.

Legjislacioni – Projektet e qeverisë: Në procesin e përdorimit më të gjerë të pagesave elektronike në Shqipëri, administrata publike mund të luajë një rol kyç. Megjithëse praktika e depozitimit të drejtpërdrejt të pagave në llogari bankare ishte një hap i madh, mund të themi se ky hap nuk është i mjaftueshëm. Këtu duhet të mbahet parasysh fakti se printimi dhe përpunimi i kartëmonedhave ka një kosto të lartë, prandaj dhe një nga qëllimet kryesore të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë e më gjerë, duhet të jetë reduktimi i përdorimit të cash-it.

Zgjerimi i pranimit të kartave në zonat rurale dhe qytetet e vogla. Kjo do të ndihmonte, qoftë nga ana e formalizimit të tregut, reduktimit të cash-

it në mbarë vendin, duke ulur ndjeshëm informalitetin, evazionin fiskal dhe rritjen e turizmit vendas, si një nga prioritetet e qeverisë.

Inovacioni. Aq rëndësi sa kanë rregullatoret, në të njëjtin nivel do të vendosej dhe inovacioni. Këtu mund të përmendim pagesat Contactless, të cilat i japin lehtësi maksimale tregtarëve për të pranuar pagesa me vlerë të vogël në një kohë shumë të shkurtër, krahasuar me çdo metodë tjetër pagese, duke mundësuar shtimin e pikave ku do të pranohen kartat dhe shtimin e numrit të transaksioneve. Ndërkohë, pajisjet mPOS (mobile point of sale) po luajnë një rol të rëndësishëm në zgjerimin dhe lehtësimin e pagesave në treg.

Kanalizimi i dërgesave të emigrantëve në sistemin bankar, e me saktë nëpërmjet instrumentit të kartave. Kjo do të ofronte lehtësi për konsumatorin, si dhe do të rriste ndjeshëm pagesat elektronike nëpërmjet kartave. Paratë e dërguara në kartë mund të përdoren me së miri për të kryer blerje, pagesa, apo marrjen e shërbimeve.

Pagesa e taksave vendore/qeveritare nëpërmjet instrumentave të kartave.

Zgjerimin e pagesave online (ecommerce). Duke analizuar sa më sipër, mund të thuhet me siguri se zhvillimi i deritanishëm në fushën e pagesave me karta ka pasur një zhvillim pozitiv në rritje, edhe pse ka ende shumë mundësi. Këto mundësi kërkojnë një teknologji të përparuar, produkte inovative dhe rregullatore të përshtatshme, për t'i dhënë hovin e duhur edhe zhvillimit të ekonomisë në vend.





Fatmira KOLA

Doktorante në Banking & Financë,
TOR VERGATA UNIVERSITY, ROMË,
ITALI

Kriza financiare e vitit 2008 shkaktoi rënien e tregjeve financiare dhe pasurive të patundshme si dhe falimentimin e disa prej bankave kryesore të investimeve. Ekonomitë e shumë shteteve vazhdojnë të vuajnë pasojat mbi papunësinë, recesionin ekonomik dhe rënien e të ardhurave për sistemin financiar. Shqipëria edhe pse nuk ishte e ekspozuar drejtpërdrejt ndaj krizës financiare, nuk ka mundur t'i shmangë pasojat, të cilat vazhdojnë të ndihen, si në nivelin e dërgesave të emigrantëve, ashtu dhe në ecurinë e ciklit të biznesit.

Sektori i ndërtimit dhe tregu i pasurive të paluajtshme ishin të parët që u përballën me ndikimin e krizës financiare në Shqipëri, e ngjashme edhe me situatën në Spanjë. Ulja e të ardhurave dhe rënia e aftësisë paguese të bizneseve që operonin në këtë sektor u pasua me rritjen e huave me probleme dhe rritjen e shpenzimeve për provizione nga bankat. Marrëdhëniet midis ciklit të biznesit dhe humbjet nga huat e bankave është një nga debatet e nxehta në literaturën e fundit

Investimet alternative, Një rrugë drejt zhvillimit të ekonomisë reale



Investimet alternative janë mundësia më e mirë që bankat të mund të investojnë likuiditetin e tepërt, duke shmangur në këtë mënyrë ekspozimet e mëdha. Investimet alternative kërkojnë njohuri specifike në fushën e financës dhe aftësi menaxheriale, e për këtë është thelbësore prania e sistemit bankar si ndërmjetës, konsulent dhe partner strategjik.



ekonomike, sidomos në lidhje me analizën e stabilitetit financiar. Problemi i huave me probleme është konsideruar të jetë një nga shkaqet më të mëdha në uljen e të ardhurave për sistemin bankar në Shqipëri. Përballja me rritjen e huave me probleme pas një "boom"-i në kreditimin e ekonomisë është karakteristikë e vendeve në zhvillim,



Shqipëria paraqet potencial të lartë edhe për investimet në infrastrukturë, si: autostrada, hekurudha dhe aeroporte, e cila është një formë e drejtpërdrejtë e mbështetjes ekonomike, e kjo do të ishte me rëndësi të madhe për ekonominë, pasi do të lehtësonte shpenzimet publike dhe do të rriste konkurrencën midis firmave. Pjesëmarrja e sistemit bankar në këto investime do të ishte një përparësi për të gjitha palët e interesuara.



pasi ngopja e tregut dhe maturimi i shumë produkteve shkakton rënien e lakores së kërkesës dhe për t'i rezistuar tregut, bizneset duhet të krijojnë produkte novatore, ose janë të detyruar të mbijetojnë, në kushtet e një konkurrence agresive.

Në Shqipëri tregu financiar ka ende shumë potencial për t'u zhvilluar. Prania e tregut të kapitaleve do të kishte ndikim pozitiv në rritjen e formalizimit të ekonomisë dhe lehtësimin e përthithjes së kapitalit për shumë biznese, por edhe mundësi investimi për të gjithë investuesit. Popullsia shumë e re në Shqipëri është një pikë shumë e fortë për zhvillimin e investimeve alternative, si për rritjen e kërkesës për investime, ashtu edhe në përshtatjen dhe përdorimin e teknologjive më të reja. Pavarësisht transformimit në sistemin bankar dhe ecurisë pozitive të rezultateve financiare që kanë pasur bankat gjatë këtyre viteve, në Shqipëri vijon të mbizotërojë një kulturë e dobët financiare dhe shumë investues ende nuk i shohin bankat si partnere, e shkaktuar kjo klimë edhe nga falimentimi i skemave piramidale. Gjatë një analize vrojtuese, të kryer për analizuar përfaqshen së individëve ndaj sistemit bankar, rezultoi se nga një kampion prej 300 pyetësorësh të zhvilluar me individë të zgjedhur në mënyrë rastësore, ku 80% e tyre banonin në zonën e Tiranës dhe Durrësit, si dhe 20% në qytetin e Beratit, vetëm një numër modest përdorte

e-banking dhe se afërsisht gjysma e tyre nuk kanë arritur të bëjnë diferencën midis kartës së kreditit dhe kartës së debitit, për të mos paraqitur këtu mungesën e informacionit mbi forma të tjera investimi, si: franshizë, fonde private kapitalesh, Venture Capital, fonde të përbashkëta investimi, fonde mbrojtëse dhe fonde të infrastrukturës. Megjithëse kanë kaluar shumë vite nga falimentimi i skemave piramidale, pasojat e tyre ndihen ende, kryesisht të ata individë që janë mbi moshën 50 vjeç. Për të kapërcyer këto pengesa duhet të investohet më shumë në edukimin e individëve lidhur me kulturën bankare, pasi nuk ka kohë për të menduar të shkuarën dhe të aludojmë mbi të ardhmen për faktorë që nuk varen nga ne, por duhet të reagojmë me mundësitë dhe potencialet që kemi, për të pasur një të ardhme financiare me të sigurt.

Në zhvillimin e tregjeve financiare një rol të rëndësishëm luan demografia e një vendi. Situata demografike në Shqipëri është e favorshme për zhvillimin e tregjeve financiare, pasi moshë mesatare e popullsisë është 34.7 vjeç, duke ofruar një treg me potencial të lartë për investimet alternative. Për popullsinë në moshë deri në 35 vjeç individët kanë kërkesë të lartë për produkte dhe investime në hua hipotekare, për të siguruar jetesën e tyre. Gjatë moshës 35-50 vjeç arrihet densiteti më i lartë i pasurisë dhe individët kërkojnë t'i investojnë këto fonde, për të siguruar të ardhura të sigurta edhe në moshën e tretë. Këtu është momenti që t'i jepet përparësi formave alternative të investimeve edhe pse në periudhën afatmesme bizneset do të vazhdojnë të përdorin gjerësisht sistemin bankar për t'u financuar dhe individët do të zgjedhin bankat për të investuar fondet e tyre. Disa banka që operojnë në treg nuk mund të ofrojnë një paketë të plotë shërbimesh për klientët e tyre si: E-banking, etj. Në kushtet aktuale, kur bankat gjenden me sasi të lartë likuiditeti, një rritje e prodhimit të brendshëm bruto me ritme më të ngadalta ndikon negativisht në rezultatet financiare, pasi sasia e lartë e likuiditetit është kosto oportune për bankat, pra një fitim i munguar. Prodhimi i brendshëm bruto ka korrelacion të fortë me rezultatet financiare, pasi nënkupton të ardhura me të larta për individët dhe familjet dhe më shumë fonde në dispozicion, për të paguar këstet e huave dhe për të investuar kursimet e tyre pas konsumit. Në Shqipëri mbetet shqetësues ndikimi politik në klimën e biznesit. Kjo krijon pasiguri për bizneset në investime

për projekte afatgjata. Kjo pasiguri e bizneseve transmetohet edhe te institucionet financiare, pasi paraqitet pasiguri në ruajtjen e ritmit të arkëtimit nga ana e bizneseve dhe një ndryshim në klimën politike do të ulë pritshmëritë e të ardhurave, duke rritur problemet e likuiditetit të biznesit ndaj kreditorëve, si dhe do të vazhdonte të rriste nivelin e huave me probleme, që mbetet shqetësues jo vetëm në vendet e rajonit, por edhe vendet e Bashkimit Europian. Zhvillimi i tregut të kapitaleve dhe formave alternative të investimeve duhet të shoqërohet edhe me edukimin e bizneseve dhe individëve mbi kulturën financiare. Duke marrë në konsideratë potencialin e Shqipërisë, zhvillimet e ekonomisë europiane dhe përparësinë që paraqet popullsia me moshe të re, një vlerë e shtuar janë të rinjtë që kanë studiuar në universitetet më të mira në botë, të cilët mund të integrojnë eksperiencat e tyre.

Bankat mund dhe duhet të orientohen drejt konsulencës mbi investimet alternative për individët. Gjithashtu, krijimi i një burse kapitalesh do të ndikonte pozitivisht në rritjen e eficiencës së tregjeve, që nga ana tjetër do të rriste formalizimin e ekonomisë dhe përthithjen e investimeve financiare. Krijimi i një tregu të përbashkët me Kosovën do të ndikonte pozitivisht edhe në ruajtjen e qëndrueshmërisë së monedhës. Financimi i Start-up-eve dhe Venture Capital përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejt në kapitalin

aksionar është ndër format më efektive të financimit, për bizneset që kërkojnë kapital për të filluar biznesin, ose që ta zhvillojnë atë. E njëjta gjë vlen edhe për investimet në pasuri të paluajtshme, që kanë për qëllim përmirësimin e zonave urbane dhe atyre të pazhvilluara.

Shqipëria paraqet potencial të lartë edhe për investimet në infrastrukturë, si: autostrada, hekurudha dhe aeroporte, e cila është një formë e drejtpërdrejtë e mbështetjes ekonomike, e kjo do të ishte me rëndësi të madhe për ekonominë, pasi do të lehtësonte shpenzimet publike dhe do të rriste konkurrencën midis firmave. Pjesëmarrja e sistemit bankar në këto investime do të ishte një përparësi për të gjitha palët e interesuara. Këto janë investime që kërkojnë nivel të lartë kapitali dhe do të ishte shumë eficient në një sistem prokurimi transparent dhe meritokratik, pasi në të kundërt koston dhe pasojat negative në ekonomi do të ishin të konsiderueshme. Zhvillimi i investimeve alternative do të promovonte edhe rritjen e dërgesave nga shqiptarët që punojnë jashtë Shqipërisë. Investimet alternative janë mundësia më e mirë që bankat të mund të investojnë likuiditetin e tepërt, duke shmangur në këtë mënyrë ekspozimet e mëdha. Investimet alternative kërkojnë njohuri specifike në fushën e financës dhe aftësi menaxheriale, e për këtë është thelbësore prania e sistemit bankar si ndërmjetës, konsulent dhe partner strategjik.





Prof. Dr. Adrian CIVICI

President

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS, UET

Politikat monetare të bankave qendrore, sidomos atyre të mëdha me ndikim të rëndësishëm në tregjet financiare ndërkombëtare, përfshirë FED, BQE, Bankën e Anglisë, Bankën e Japonisë, etj., vazhdojnë të jenë në qendër të debateve e analizave shkencore e akademike mbi “kufijtë dhe kufizimet aktuale”, “mbi instrumentet më eficiente për arritjen e objektivave”, “mbi konceptet bazë, apo paradigmat ku mbështeten politikat monetare”, etj. Studiuesit e specializuar të kësaj fushe dhe bankierët qendrorë duket se po konvergojnë në një konsensus të përbashkët: pas krizës financiare globale të shpërthyer në 2008, politikat monetare të bankave qendrore kanë hyrë në një fazë të re ndryshimesh konjunkturorë e strukturorë, që mund të prodhojnë koncepte të reja teorike e institucionale në vitet në vazhdim.

Pas krizës përgjigja, apo reagimet e bankave qendrore ishin thujtë unike: ulja e vazhdueshme e normave bazë të interesit, mbajtja e tyre për një kohë të gjatë në nivele

Sfidat e politikave monetare Çfarë pritet pas masave të “lehtësimit sasior”?



Bankat qendrore kryesore të botës po piren të “dalim përtej manualeve klasike të politikave monetare”, në emër të inovacioneve që po kërkohen nga realiteti dhe sfidat aktuale. Në tërësinë e debateve, propozimeve apo shembujve konkretë në këtë drejtim, duket se po spikasim dy inovacione të rëndësishme: rezervat monetare në 3 nivele dhe operacionet e shenjëstruara rifinancuese afatgjata (TLTRO).



minimale thujtë zero dhe politika të forta të “lehtësimit sasior”. Ashpërsia e krizës i shtyu bankat qendrore që t’i relaksonin maksimalisht politikat e tyre monetare, fillimisht duke afuar drejt zeros normat bazë të interesit, pastaj duke adoptuar politika makroprudenciale dhe jo-



Programet aktuale të lehtësimit sasior i ekspozojnë bankat qendrore kundrejt humbjeve perspektive të të ardhurave neto të tyre, gjë që i ka shtyrë mjaft ekspertë të politikave monetare të mendojnë se në të ardhmen BQE, Banka e Anglisë, Banka e Japonisë, etj., mund të mos i rinovojnë politikat e lehtësimit sasior, duke mos qenë më të sigurtë si në fillimet e aplikimit të tyre për eficientë e tyre dhe të përqendrohen më gjerësisht në sistemin e politikave monetare jo-konvencionale, të tipit TLTRO.



konvencionale, si: blerja masive e aktiveve në kuadrin e politikave të lehtësimit

sasior, duke përmirësuar komunikimin me tregjet monetare e financiare, për të orientuar më drejt pritshmëritë e agentëve ekonomikë nëpërmjet politikave të forward guidance, e së fundi, duke kaluar në politikat e përqindjeve negative të interesit. Nevoja për zgjidhje të reja u bë frymëzuesja kryesore e inovacioneve të reja. Këto politika monetare ultra-lehtësuese arritën të shmangnin, në një masë të konsiderueshme, pasojat katastrofike që mund të shkaktonte kriza financiare: evitimin e bllokimit të tregjeve monetare, tharjen e likuiditetit, shmangjen e përhapjes së produkteve dhe derivateve financiarë toksike me rrezik të lartë, ruajtjen e ekuilibrave buxhetorë të vendeve europiane, uljen e rrezikut të besueshmërisë, etj. Debati aktual mbi politikat monetare duket se ka në qendër dilemën: a ka mbaruar tashmë një fazë e rëndësishme në instrumentet e tyre, dhe, a do përballemi së shpejti me një vizion të ri të politikave monetare?

Ekspertët e politikave monetare mendojnë se, tashmë politikat monetare jo-konvencionale të lehtësimit sasior - në Eurozonë për periudhën mars 2015 – shtator 2016 janë blerë nga BQE aktive dhe obligacioneve shtetërore rreth 1,100 miliardë euro, pra 60 miliardë euro/ muaj; gjatë periudhës 2009-2010 Banka

Kredi Hipotekore



Interes fiks **3.9%** në Eur për vitin e parë
Nga **5%** interes për periudhën e mbetur
Shpenzime **0** pas vitit të parë



Fibank

First Investment Bank

30 • Bankieri • www.fibank.al • **Qëshije kushtesh!**

TELEFONONI PA PAGESË NË
0800 01 11

www.fibank.al

e Anglisë bleu në treg mbi 200 miliardë paunde aktive të institucioneve financiare, obligacione apo borxh publik; që nga 2008, FED ka ndërmarrë programe të lehtësimit sasior mbi 1,000 miliard dollarë - si dhe uljet e vazhdueshme të normave bazë të interesit rrezikojnë të kthehen në kundër-produktive në raport me objektivat bazë të tyre. Shqetësimet përqendrohen në dy aspekte thelbësore: efektet e këtyre politikave mbi shpenzimet e konsumatorëve dhe kërcënimet për stabilitetin financiar dhe qëndrueshmërinë e sektorit bankar që ato pasqyrojnë.

Lidhur me shpenzimet konsumatore, arsyetimi themelor i hipotezës së politikave monetare lehtësuese se “ulja e normës bazë të interesit, pra ulja e çmimit të parasë ndikon drejtpërdrejt dhe tërthorazi në stimulimin e konsumit dhe investimeve”, duket se nuk po gjen vërtetimin dhe konfirmimin e pritur. Studime të orientuara në këtë fokus tregojnë se, “në Europë dhe Japoni, ku PBB/banor është i lartë dhe njëkohësisht ka një ri-shpërndarje relativisht uniforme të të ardhurave, shqetësimet dhe paqartësitë për të ardhmen – rritja e shpenzimeve për shërbimet shëndetësore, zvogëlimi i popullsisë aktive, etj. – bën që ulja e normës bazë të interesit të shkaktojë efekt të kundërt, duke çuar në reduktim të shpenzimeve dhe rritje të kursimeve”. Për shpenzimet që konsiderohen si të pashmangshme për të ardhmen, një ulje e koston së parasë aktuale përkthehet aktualisht si mundësi efektive kursimi.

Për më tepër, duke e pranuar si të vërtetë hipotezën se, “rritja e borxhit publik dhe inflacionit është një nga zgjidhjet për problemin e nivelit të borxhit të sektorit privat”, duket mjaft e vështirë që “shtimi i stokut të borxhit publik të japë efektet e shpresuara, në një sektor privat tashmë të mbingarkuar me borxhe e detyrime”. Analizat e institucioneve të specializuara në “sjelljen bankare” e gjejnë pikërisht në këtë fakt shpjegimin “pse rritja e huadhënies në eurozonë dhe vende të tjera të zhvilluara ka qenë anemike, megjithëse kosto e tij bëhej gjithnjë e më e lirë”, si rezultat i politikave monetare relaksuese. Pse normat minimale, thuajse zero, të normave bazë të interesit nuk po arrijnë të kontribuojnë në krijimin e inflacionit të shpresuar? Po t'i shtojmë kësaj faktin tjetër se, “edhe reagimi i tregjeve financiare ndaj politikave të përqindjeve negative të interesit nuk

po jepin efektet e shpresuara”, atëherë ekspertët e politikave monetare kanë filluar të kristalizojnë mendimin se, “instrumentet tradicionale kanë nevojë për diversifikim, inovacione dhe diskutim, për një përputhje më të mirë të objektivave të politikave monetare me mandatet ligjore e institucionale të bankave qendrore”. Çfarë lloj ndryshimesh apo inovacionesh mund të priten në kuadrin e politikave monetare?

Në literaturën e specializuar bankare dhe në takime të niveleve të larta të guvernatorëve dhe drejtuesve të bankave qendrore po evokohet shpesh përvoja dhe veprimet e bankës qendrore të Japonisë, i cila në vitet 2000 duke arsyetuar se, “përqindjet e ulta të normës bazë të interesit dhe blerjet periodike të obligacioneve nuk kontribuan në rritjen e inflacionit”, si dhe duke mbrojtur qëndrimin se në fund të fundit “inflacioni është përgjegjësi e bankave qendrore dhe çdo dështim konjunkturor apo afatshkurtër në orientimin e tij në përputhje me objektivin e bankave qendrore nuk është arsye e mjaftueshme për të hequr dorë nga arritja e objektivit”, u angazhua në rritjen e masës monetare, deri sa



Ekspertët e politikave monetare mendojnë se, tashmë politikat monetare jo-konvencionale të lehtësimit sasior, si dhe uljet e vazhdueshme të normave bazë të interesit rrezikojnë të kthehen në kundër-produktive në raport me objektivat bazë të tyre. Shqetësimet përqendrohen në dy aspekte thelbësore: efektet e këtyre politikave mbi shpenzimet e konsumatorëve dhe kërcënimet për stabilitetin financiar dhe qëndrueshmërinë e sektorit bankar që ato pasqyrojnë.



indeksi i inflacionit të arrinte nivelin e parashikuar të objektivit.

Më shumë se sa veprimi konkret i rritjes së masës monetare, çështja qëndron në faktin se tashmë duket se disa “paradigma apo kufij të politikave monetare mund të zgjerohen e riformatohen në horizonte të reja”. Bankat qendrore kryesore të botës po priren të “dalin përtej manualeve klasike të politikave monetare”, në emër të inovacioneve që po kërkohen nga realiteti dhe sfidat aktuale. Në tërësinë e debateve, propozimeve apo shembujve konkretë në këtë drejtim, duket se po spikasin dy inovacione të rëndësishme: rezervat monetare në 3 nivele dhe operacionet e shenjëstruara rifinancuese afatgjata (TLTRO). Thelbi i tyre qëndron në vizionin dhe përpjekjet për të shkëputur, ose ndarë ri-lançimin monetar nga përqindjet e interesit të tregut.

“Rezervat monetare në 3 nivele” ilustronjë qartësisht se baza monetare dhe obligacionet e thesarit, që presupozohet se në mjaft raste janë zëvendësues apo plotësueset më të afërta të bazës monetare, në fakt sipas ekspertëve të bankingut qendror rezultojnë cilësisht të ndryshme nga njëra-tjetra. Obligacionet e thesarit emetohen në treg mbi bazën e një çmimi të caktuar, që është përqindja e interesit. “Përqindja e interesit” e paguar për rezervat monetare, në fakt është thjesht një përqindje interesi teorike, e cila mund të cilësohet edhe si një “pagesë apo zbritje ndaj mbajtësve të këtyre rezervave. Sipas E.Lonergan i M&G Investments, “bankat qendrore mund të fiksojnë në treg përqindje interesi, duke përcaktuar një përqindje interesi vetëm mbi një pjesë të rezervave monetare shtesë. Nëse dëshirojnë, bankat qendrore mund të paguajnë për këtë diferencë një prim, ose të bëjnë një zhvlerësim të titujve në raport me vlerën e tyre aktuale. Në të ardhmen, duket se do jetë normale që rezervat e detyrueshme të reduktohen, duke përdorur mekanizmin e përqindjeve negative të interesit, ndërkohë që rezervat shtesë do të përfitojnë prime”.

Në diskutimet aktuale, qoftë dhe ato me natyrë akademike e teorike ekziston mendimi se, në këtë rast kemi të bëjmë “me politika të thjeshta buxhetore të aplikuar nëpërmjet sektorit bankar”, por një pjesë e ekspertëve financiarë vlerësojnë se në këtë rast “bëhet fjalë thjesht për politika monetare të reja të pa zbatuara deri tani nga bankat qendrore.....se, rritja e ndikimit

dhe efekteve të politikave monetare mbi sipërmarrjet dhe konsumatorët përbën një etapë evidente në një të ardhme të afërt”.

Bankat qendrore të Suedisë, Zvicrës, Danimarkës, Japonisë, etj., kanë vendosur tashmë një sistem specifik rezervash valutore në disa nivele, duke synuar zbutjen e efekteve të përqindjeve negative të interesit të bilancet e bankave private, nëpërmjet aplikimit të përqindjeve negative të interesit vetëm në një nivel, apo sasi të caktuar të rezervave monetare të këtyre bankave. Kështu p.sh.: në Bankën e Japonisë, një pjesë e rëndësishme e rezervave valutore (Basic Balance) vazhdon të paguhet me përqindje pozitive interesi; një pjesë tjetër më modeste e fiksuar nga Banka e Japonisë (Macro Add-on balance) paguhet apo shpërblehet me 0%; ndërkohë që normat negative të interesit aplikohen vetëm mbi rezervat e reja monetare (Policy-Rate Balance) të krijuara nga bankat. Ky sistem i ri është i destinuar të ndikojë në çmimin e transaksioneve, por ai nuk pritet të ketë ndikim në rentabilitetin e bankave, ndërkohë që objektivi i tij themelor duket se është fakti që përqindjet negative të interesit duhet t’i nxisin bankat të japin hua duke u mbështetur te rezervat e reja të krijuara nga politikat e lehtësimit sasior,

por pa cënuar rentabilitetin e tyre.

Nga ana tjetër, përsa i përket sistemit të TLTRO-ve, qëllimi final i zbatimit të tij është “dhënia e rezultateve konkrete në ekonominë reale të politikave të lehtësimit sasior dhe jo thjesht përmirësimet e bilanceve të bankave, apo rritja e çmimit të aktiveve nëpërmjet tyre”. Pse sistemi TLTRO po konsiderohet si një inovacion në politikat monetare dhe rolin e bankave qendrore? Sepse, duke ju referuar parimit të Walter Bagehot, “bankat qendrore japin hua vetëm me përqindje interesi ndëshkuese, ose e shumta duke aplikuar një prim në raport me atë çka ato paguajnë për rezervat monetare”, ndërkohë që në mjediset e bankave qendrore, vendimi i fundit i BQE-së, që TLTRO do t’iu ofrohet bankave me të njëjtën përqindje që paguhen rezervat monetare, konsiderohet si një inovacion i ri i politikave monetare.

Në këtë kuptim, BQE e ka shprehur hapur se tashmë ekzistojnë tre drejtime nëpërmjet të cilave mund të realizohen politikat monetare lehtësuese: kohëzgjatja e tyre, rreziku i besueshmërisë dhe çmimet ose niveli i inflacionit. Programi i TLTRO duket mjaft më radikal se politikat e lehtësimit sasior, në këndvështrimin se ky program është shumë më i gjerë në raport me tri drejtimet e lartpërmendura. Deri

tani, TLTRO është ushtruar për periudha kohe 5 vjeçare, por prirjet më të fundit lënë të kuptohet se ky instrument mund të bëhet një nga më kryesorët në arsenalin e politikave monetare, sidomos në aspektin e një ndarjeje të përqindjeve të interesit të TLTRO, në raport me normat e interesit që BQE paguan për rezervat monetare.

Programet aktuale të lehtësimit sasior i ekspozojnë bankat qendrore kundrejt humbjeve perspektive të të ardhurave neto të tyre, gjë që i ka shtyrë mjaft ekspertë të politikave monetare të mendojnë se në të ardhmen BQE, Banka e Anglisë, Banka e Japonisë, etj., mund të mos i rinovojnë politikat e lehtësimit sasior, duke mos qenë më të sigurtat si në fillimet e aplikimit të tyre për eficiencën e tyre dhe të përqendrohen më gjerësisht në sistemin e politikave monetare jo-konvencionale, të tipit TLTRO. Tashmë, që prej vitit 2014, BQE ka lançuar dy programe të konsiderueshme TLTRO, ndërkohë që në një horizont afatshkurtër janë planifikuar dhe disa operacione të tjera analoge. Sa më shumë bankat që marrin pjesë në këto programe të kreditojnë ekonominë reale, aq më shumë mund të përfitojnë nga financimet TLTRO me përqindje interesi më të leverdishme, se ato që BQE propozon zakonisht.



Përgjegjshmëria Sociale



Së bashku festat janë më të bukura
Në 15 dhjetor banka dhuroi paketa ushqimore për 250 familje në të gjithë Shqipërinë, në bashkëpunim me bashkitë më të mëdha në vend.



Në fjalën e tij përshëndetëse në “Qendrën Sociale Multidisiplinare” në Tiranë, ku së bashku me stafin e Alpha Bank Albania u shpërndanë paketa ushqimore për 50 familje, z. Periklis Drougkas, Drejtor i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania theksoi se festat e fundvitit janë një periudhë e veçantë që sjell njerëzit më afër familjes dhe miqve; është një periudhë ku duhet të jemi mirënjohës për çfarë kemi dhe të ndihmojmë ata që kanë më pak se ne.



“Nata Arabe” në Teatrin e Metropolit
Kjo ishte një nga shfaqjet më të suksesshme të mbështetura nga ABI Bank, ku interpretuan emra të njohur të skenës shqiptare si: Ema Ndoja, Naun Shundi, Dasara Xhagolli, etj.

“Mr.&Mrs. Investo në Pazar”

Banka mbështeti veprimtarinë që kishte për qëllim promovimim e trashëgimisë kulturore të qytetit, si dhe nxitjen e bizneseve për të investuar në këtë hapësirë unike përsa i përket arkitekturës dhe potencialit të zhvillimit.



“Vrapo Për Fëmijët”

Më 4 dhjetor u organizua në Tiranë veprimtaria: “Vrapo për fëmijët 2016”, një organizim për mbledhjen e fondeve nga pjesëmarrës si: qytetarë, grupe, institucione dhe biznese në Tiranë. Kjo nismë u mbështet nga stafi i bankës.



“Film Music në Pianodrom”

Dhjetori artistik në Tiranë startoi me një mbrëmje të veçantë në Universitetin e Arteve, ku u mbajt një koncert nga dy artiste të mirënjohura të skenës shqiptare. Projekti artistik “Film Music në Pianodrom” u mbështet nga ABI Bank, duke vlerësuar muzikën e filmit si një nga faqet më të vyera të muzikës shqiptare.

Komedia “Plako r’majt e jotja”

Banka ishte sponsori kryesor i komedisë stand-up: “Plako r’majt e jotja”. Pas shfaqjes në Teatrin Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, kjo komedi udhëtoi në disa qytete të Shqipërisë.

“Mbroni Shpellarin” me Romir Zallën

Kjo sfidë teatrore e mbështetur nga ABI Bank u shfaq jo vetëm në Tiranë, por dhe në disa qytete të tjera të vendit si: Pogradec, Korçë, Vlorë, etj.

Banka pranë sportit

Mbështetja për një jetë të shëndetshme që ushtrimi i sportit siguron, është gjithmonë në fokus. Tashmë banka është sponsori kryesor për këtë sezon sportiv i të gjitha ekipeve sportive përbërëse të Klubit Sportiv “Studenti”.

Banka vlerësohet me dy çmime për Përgjegjësinë Sociale të Korporatës

ABI Bank u nderua me çmimin “Bleta e Artë 2016” për Përgjegjësinë Sociale, për kontributin e saj në përmirësimin e jetës së komunitetit. Çmimi iu dorëzua z. Andi Ballta Drejtor i Përgjithshëm i ABI Bank nga z. Arben Ahmetaj, Ministër i Financave.



Në veprimtarinë e ndarjes së çmimeve nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, organizuar në datë 17 dhjetor, ABI Bank mori çmimin “Banka më pranë komunitetit”.



Gjatë periudhës tetor – dhjetor BKT mbështeti institucionet dhe veprimtaritë si më poshtë:

Fondacioni Arsivor Malatya (Malatya Egjtim Vakfi - MEV): donacion për 60 studentë për përmbushjen e nevojave të tyre financiare gjatë vitit shkollor.

Gjysmëhëna e Kuqe Turke: në mbështetje të "Kizilay Annesi Projesi", në kuadër të projektit që mbështet jetimët dhe fëmijët e familjeve të varfra.

Sistemi i bashkëpërdorimit të biçikletave në Tiranë: në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës filloi zbatimin e projektit “Sistemi i bashkëpërdorimit të biçikletave”. Nëpërmjet donacionit të ofruar për këtë qëllim synohet përmirësimi i infrastrukturës së rrugëve të biçikletave.

Përgjegjshmëria Sociale

Drejtoria Rajonale e Bujqësisë - Elbasan: mbështeti financiarisht Drejtorinë për organizimin e eventit me rastin e festave të funditit 2016. Ky ishte gjithashtu një rast për të vendosur marrëdhënie mes BKT-së dhe fermerëve lokalë, të cilët morën pjesë në këtë event.

Instituti i Shëndetit Publik: ndihmoi në publikimin e përmbledhjes së legjislacionit shëndetësor në 500 kopje si dhe me disa pajisje zyre.



Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR) Vlorë: sponsorizoi eventin e organizuar nga DAR Vlorë, me rastin e përfundimit të vitit shkollor 2015-2016.

Zyra Arsimore Delvinë: dhuroi disa pajisje zyre, me qëllim lehtësimin dhe përmirësimin e kushteve të punës.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Vlorë: sponsorizoi rindërtimin e parkut jashtë institucionit.

AKSHI: i dhuroi mobilje zyre të reja, për përmirësimin e kushteve të punës.

Ambasada Shqiptare në Ankara: mbështeti financiarisht Ambasadën Shqiptare në Ankara, për organizimin e festës kombëtare të Ditës së Pavarësisë, në 28 nëntor.



Ceremonia e Diplomimit në FASTIP: BKT është një partner i rëndësishëm i UAMD-së në FASTIP dhe ka kontribuar masivisht, gjatë këtyre 9 viteve, në këtë program unik të partneritetit publik - privat midis qeverisë shqiptare, asaj gjermane, UAMD-së dhe biznesit shqiptar. Gjatë ceremonisë së diplomimit, Rektori i UAMD, me rastin e

10-vjetorit të UAMD, i dorëzoi z. Pencablil titullin honorifik "Doctor Honorius Causa" për kontributin e veçantë personal të tij në këtë projekt. BKT ishte edhe një nga sponsorët kryesorë të ceremonisë së diplomimit.



Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koco Glliozheni": sponsorizoi dekorin për pemën e Vitit të Ri të vendosur në spital.

Shkollat "Naum Veqilharxhi" dhe "Demokracia", Korçë: mbështeti veprimtarinë kundër dhunës.

Organizata "Qyteti shqiptar" e Krujës: mbështeti financiarisht organizimin e ngjarjes, me rastin e festave të fundvitit 2016.

CREDINS bank

Në mbështetje të Dhomës Britanike të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë

Për përgatitjet dhe organizimin e konferencës në promovimin e zhvillimit të Turizmit dhe Agrobiznesit. Kjo mbështetje synoi krijimin e një platforme për nxitjen e prodhuesve për të kërkuar konsulencë në mënyrën sesi të zhvillojnë biznesin e tyre dhe si t'i shtojnë vlerë produktit të tyre në kërkim të tregjeve të reja, duke ofruar gjithashtu zgjidhje financiare dhe paketa sigurimi për bizneset.

Në mbështetje të fushës akademike, Mirëpriti në mjediset e saj Konferencën CEST 2016, me tematikë "Globalizimi, zhvillimet ekonomike, përsëritja e cikleve të historisë, teknologjia dhe inovacioni".

Kultura në fokus të politikave të përgjegjësisë sociale

Banka luajti një rol kyç në organizimin e promovimit të librit të Prof. Dr. Paskal Milo me titull "Udhëkryqë Shqiptaro - Gjermane" dhe vëllimin me poezi të shkrimtarit Dritëro Agolli, në kuadër të 85 vjetorit të lindjes së tij. Gjithashtu, këtë vit me rastin e festave të 28-29 nëntorit, banka mundësoi çeljen e ekspozitës me temë "100 vjet Flamur", pranë

Qendrës Shqiptare të Trashëgimisë në qytetin e Korçës, ku u promovuan vlerat kombëtare.

Partnere e intucioneve lokale

Këtë fundviti banka zgjodhi të përkrahë Bashkinë e Pogradecit në përmirësimin e pamjes së qytetit me dekorin festiv për festat e fundvitit. Gjithashtu, banka ka mbështetur Spitalin e Beratit për mobilimin e dhomave të pacientëve, duke sjellë rritje të përmirësimit të kushteve spitalore dhe ofrimin e një shërbimi sa më cilësor.

"Credins Bank DHURON"!

Kjo nismë, e ndërmarrë nga vetë punonjësit e 57 degëve të bankës për t'u organizuar dhe dhuruar rroba për grupmosha të ndryshme dhe lodra për fëmijët në nevojë, bëri një dhurim pranë "Qendrës Kombëtare të Emergjencave". Stafii iu bashkua thirrjes së Club FM radio në emisionin "Klubi i mëngjesit" në maratonën e ndihmave për fëmijët e paprivilegjuar të Shqipërisë. Në vijim të kësaj nisme, protagonistë të dhurimit ishin edhe fëmijët e shkollës 9- vjeçare "Sabaudin Gabrani", në qytetin e Tiranës, të cilëve ju dhuruan 75 çanta shpine.



Në këtë kontekst, banka kontriboi gjithashtu për Fshatin SOS dhe "Down Syndrome Albania", duke blerë kartolina të ideuara dhe të punuara nga vetë fëmijët.

Fibank First Investment Bank

#ShperndaniDashuri

Këtë vjeshtë, Fibank erdhi me një fushatë në median sociale, për të përmbushur angazhimin e saj në Përgjegjshmërinë Sociale. Fushata u konceptua si një fotografi e Fshatit të Fëmijëve SOS, duke ripostuar, apo komentuar në @shperndaniDashuri nëpër të gjitha kanalet e Fibank në mediat sociale. Fondet u dhuruan Fshatit.

Kartolina e Festave të Fundvitit nga Down Syndrome Foundation Shqipëri & Fshati SOS
Në kuadër të veprimtarive për fundvitin,

Përgjegjshmëria Sociale



ishte edhe mbështetja e Fondacionit “Down Syndrome Albania” & Fshatit SOS. Për të katërtin vit radhazi banka uroi kolegët dhe bashkëpunëtorët nëpërmjet një kartoline të veçantë të punuar me dorë nga fëmijët e Fondacionit “Down Syndrome Albania” & Fshati SOS.




INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK
rëndësi kanë vlerat

Stafi i Bankës ofroi mbështetjen e tij duke kontribuar në mënyrë vullnetare në blerjen e mjeteve shkollore për 45 fëmijë në nevojë të shkollës nëntëvjeçare “Ahmet Gashi”, Laprakë.



Dhuroni Gjak, shpëtoni një jetë!

Banka ISBA organizoi, për të shtatin vit radhazi, nismën e dytë të dhurimit të gjakut për këtë vit, në datat 17 - 18 nëntor. Gjaku i grumbulluar në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit, shkon në pjesën më të madhe (70- 80%) për mbulimin e nevojave për gjak të fëmijëve talasemikë.



Mentorimi vullnetar në shkollat e mesme të vendit për vitin akademik 2016-2017

Në vijim të bashkëpunimit me shoqatën “Junior Achievement Albania” banka u angazhua edhe këtë vit për të qenë pjesë e këtij organizimi. Këtë vit programi i Junior Achievement pritet të shtrihet në më shumë se 170 shkolla të mesme dhe paralelisht në të gjitha shkollat e arsimit bazë (sistemi k-9).

Eventi i Bamirësisë: Run for Children 2016/Vraponi për fëmijët 2016!

Në ditët e para të dhjetorit, kolegë të Bankës ISBA morën pjesë në maratonën “Vraponi për Fëmijët 2016”, organizuar nga ana e Fondacionit Vodafone dhe MRDC (Medical Response Diplomatic Corps). Fondet e mbledhura nga ky organizim do të shkojnë për trajtimin mjekësor të fëmijëve që vuajnë nga sëmundja e rëndë e kancerit.



25 Nëntori – Dita Ndërkombëtare për eliminimin e Dhunës ndaj Grave

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të eliminimit të Dhunës Ndaj Grave dhe në mbështetje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, u organizua një fushatë ndërgjegjësuese të të gjithë kolegët, duke shpërndarë një kartolinë interesante si edhe disa materiale që përmbanin të dhëna statistikore dhe fakte që flasin qartë mbi domodososhmërinë e eliminimit të dhunës ndaj grave. Kartolina u vendos jo vetëm në email footer, por edhe në të gjitha ekranet e ATM-ve të bankës në të gjithë vendin.



Takim me bizneset e industrisë ushqimore
Me nismë të bankës ProCredit biznese të industrisë ushqimore nga i gjithë vendi u ftuan në takimin “Business to Business”. Në fokus të kësaj veprimtarie ishte nxitja dhe zhvillimi i marrëdhënieve të biznesit midis klientëve të bankës ProCredit në shkallë vendi.



Inaugurohet Qendra Rajonale e Trajnimit në Prevallë të Prizrenit

Banka inauguroi qendrën rajonale të trajnimeve, ndërtuar në Prevallë të Prizrenit e cila do të ofrojë trajnime për stafin.



Mbështet workshop-in “Sfidat e zhvillimit rajonal”

Ky workshop, organizuar nga Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti Ekonomik Shkodër, kishte në fokus nxitjen e ideve dhe prritjen e aftësive analitike dhe prezantuese të studentët, nëpërmjet përgatitjes së temave me interes.



PRODUKTE TË OFRUARA NGA INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK



ALL [IN] ONE PLAN - PAY - SAVE

➤ **TRANSPARENT SI KARTA JUAJ**

- Menaxhim të llogarisë tuaj, Planifikim - Pagesa - Kursime.
- Kryeni kurdo dhe kudo veprime bankare të sigurta.
- Kërkoni gjendjen e parave me sms dhe llogarisë me e-mail.
- Elimino Cash-in, përdoreni kartën në ATM - POS - ONLINE.
- Paguani shpejt, lehtë, të mbrojtur nga **PayPal**.



PA GARANTOR

➤ **KREDI KONSUMATORE**

- **NORMA INTERESI TË PANDRYSHUESHME**
përgjatë të gjithë ciklit të kredisë, duke filluar nga 9% në lekë për klientë pagamarrës dhe nga 10% për jo pagamarrës.
- **APROVIM I MENJËHERSHËM**
dhe ju do të mund të merrni kredisë shpejt dhe lehtë.
- **VËRTETONI QË MERRNI NJË PAGË**
nuk është kusht që pagën ta merrni në bankën tonë.



MIRATIM I MENJËHERSHËM

➤ **KREDI BIZNES I VOGËL**

- **DERI NË VLERËN 1 MILION LEKË**
 - NUK NEVOJITET KOLATERAL
 - APROVIM DERI NË TRE DITË
- **DERI NË VLERËN 5 MILION LEKË**
 - NUK NEVOJITET KOLATERAL
 - AFAT SHLYERJE DERI NË 84 MUAJ
 - KONSIDEROHET ÇDO TIP KOLATERALI

WWW.ICB.AL

☎ 04 22 56 254



INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK
rëndësi kanë vlerat



Përgjegjshmëria Sociale



Mbështet Bashkinë e Tiranës në projektin e ndërtimit të 5 këndeve të lojrave në kryeqytet Kryetari i Bashkisë Z. Erjon Veliaj dhe Drejtori i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank Z. Christian Canacaris inspektuan fillimin e punimeve për këndin e dytë në këtë projekt. “Ky është këndi i dytë nga 5 këndet për këtë vit dhe unë jam i lumtur tju njoftoj se bashkëpunimi i Raiffeisen Bank me Bashkinë e Tiranës do të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm për 5 këndet e tjera” tha në fjalën e tij Drejtori i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank Z. Canacaris.



Dhuron mbi 200 tituj librash për Bibliotekën Publike të qytetit të Fierit

Banka vijon mbështetjen e projektit “Qyteti i Lexuesve”. Këtë herë mbështeti nismën e Bashkisë Fier në realizimin e projektit: “Qyteti i lexuesve”, në bashkëpunim me Botimet “Dudaj”.

Bamirësia nuk të varfëron

Në këtë prag festash, të gjithë punonjësit e Raiffesien Bank u bënë pjesë e fushatës së Fondacionit “Fundjavë Ndryshe”. Falë kontributit të tyre u bë e mundur mbledhja e mbi 2 tonë ushqime, që u shpërndanë në 15 familje në varfëri ekstreme, ku secilës prej tyre iu siguria baza ushqimore për 3 muaj.



Mbështet realizimin e Konferencës së I-rë Prindërore për Aftësinë e Kufizuar Intelektuale në Shqipëri, organizuar nga Fondacioni “Down Syndrome Albania” (DSA)

Kjo konferencë synoi mbledhjen e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, profesionistëve të fushës dhe përfaqësuesve të institucioneve të qeverisjes vendore, për të diskutuar mbi shërbimet ndaj individëve me aftësi të kufizuara intelektuale, autonomisë, të drejtave dhe sfidave drejt arsimit gjithëpërfshirës dhe qasjes drejt rrugës së punësimit.

Raiffeisen Bank, nga bizneset e para që angazhohet zyrtarisht për fuqizimin e grave në nëpërmjet integritimit të Parimeve Globale të Fuqizimit të Grave në praktikën e saj të punës. Në ceremoninë e organizuar nga Bashkia Tiranë, me mbështetjen e UN Women dhe qeverisë suedeze, Znj. Valbona Zeneli, Drejtore e Burimeve Njerezore e Raiffeisen Bank, nënshkroi bashkë me Z. Erjon Veliaj, Kryetar i Bashkisë së Tiranës, deklaratën për zyrtarizimin e mbështetjes së Raiffeisen Bank për përpërimin e barazisë midis grave dhe burave.



Përgjegjësia Sociale në Bankën Societe Generale Albania

Çdo vit, Banka Societe Generale Albania merr pjesë në veprimtari të Përgjegjësisë Sociale të Shoqërisë, duke falur dhurata dhe mbështetje. Në bankë u krijuan 14 ekiye në mënyrë vullnetare, ku 153 persona pranuan sfidën, për 3 muaj. Të gjitha veprimtarië u komunikuan në Facebook dhe Instagram. Veprimtarië e kryera ishin:

1. Një ditë me fëmijët jetimë nga 0 - 6 vjeç (Shkodër)
2. Një ditë me fëmijët e shtruar me leuçemi
3. Kopështi i vogël botanik për kopshte fëmijësh
4. Nismë në Qendrat për të moshuarit (Berat)
5. Argëtim për fëmijët autikë dhe me sindromën Down
6. Ndërtim i një udhe këmbësorësh në natyrë (sinjalistikë udhëzuese për turistë)
7. Një ditë me fëmijët jetimë nga 6 - 14 vjeç (Shkodër)
8. Donacioni për fëmijët e braktisur në Maternitet (Dhoma e ëngjëjve - Maternitet M. Geraldinë)
9. Një ditë me fëmijët jetimë nga 6 - 18 vjeç (Tiranë)
10. Lyeni trungjet e pemëve me gëlqere (mbroni pyjet)
11. #FundjavëNdryshe
12. Dhuro Gjak
13. Një ditë me të moshuarit në azil
14. Bibliotekë e brendshme për shkollë 9-vjeçare



Dhurimi i Gjakut

Për të tetin vit radhazi, më 14 tetor, banka në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, realizoi veprimtarië në saj humane të dhurimit të gjakut.



Festa e Verërave, Pogradec

Për dy ditë me rradhë, më 16 dhe 18 dhjetor, prodhues vendas të verërave paraqitën prodhimet e tyre para një publiku të gjerë.

Dhurata për fëmijët jetimë

Dhurata këtë fundvit shkon për fëmijët jetimë në komunitet, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar. Në datën 22 dhjetor rreth 100 fëmijë jetimë që jetojnë në komunitet, pas një koncerti të organizuar prej tyre, morën dhurata të mundësuar nga Tirana Bank.

Adopto një kopësht

Tirana Bank i është bashkuar nismës së Bashkisë Tiranë: “Adopto një kopësht”. Në këtë kuadër, banka kontribuoi në pajisjen me mobilje të reja të çerdhës në rrugën “Komuna e Parisit”.

“Gatuaj një pjatë më shumë”

Banka ishte sponsor i eventit të datës 25 dhjetor: “Gatuaj një pjatë më shumë”. Të ftuarit e nderit në këtë tryezë ishin të pas-trehët, të varfërit dhe njerëzit e vetmuar.



Dhurata për fëmijët për Vitin e Ri 2017 Punonjësit e Union Bank, në prag të Vitit të Ri, grumbulluan dhurata për fëmijët e zonës periferike: “Rruga Ura” në Tiranë ku jeton një komunitet jo i vogël familjesh në nevojë. Fëmijët e kësaj zone u surprizuan nga dhuratat e paketuara enkas për ta.



Ndihma për familjet në nevojë
Stafi i Union Bank, kontribuoi me veshje dhe ndihma ushqimore për t'u ardhur në ndihmë disa familjeve më të varfëra në periferitë të Elbasanit.

Promovon marrëdhënien me Biznesin
Union Bank, sponsor zyrtar i “Kombëtares Kuq e Zi”, vazhdon promovimin e marrëdhënieve me biznesin në ndeshjen Shqipëri-Maqedoni. Biznesmenë nga Tirana, Elbasani, Kruja, Lezha dhe Shkodra, të rekomanduar dhe të shoqëruar nga drejtorët e degëve UB në qytetet përkatëse, përfituan bileta falas nga banka për ndeshjen e parë të eliminatorëve të Botërorit 2018.

Punonjësit e Union Bank dhuruan gjak për fëmijët talasemikë.
Dhurim i gjakut u organizua në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar me sloganin “20 minuta për të qenë një hero”.



Veneto Banka ishte e pranishme në eventin e prezantimit të shoqatës “Albalaureati”, organizuar nga fondacioni IIDS dhe Ambasada Italiane në Tiranë, duke mbështetur të rinjtë shqiptarë që kanë mbaruar studimet në universitetet italiane.



NJOFTIM ASD

ASD fiton çmimin

“Përmirësimet e Sistemit të Sigurimit të Depozitave”

Në takimin e përgjithshëm vjetor të Shoqatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI) që u zhvillua në Seul, Kore e Jugut, në datat 23-28 tetor 2016, Agjencia e Sigurimit të Depozitave u shpall fituese e çmimit “Përmirësimet e Sistemit të Sigurimit të Depozitave”. ASD u përfaqësua në këtë takim me z. Genci Mamani, Drejtor i Përgjithshëm, i cili mori në dorëzim çmimin prestigjioz nga z. Thomas M. Hoenig, President i IADI-t. ASD kishte aplikuar për këtë çmim, i cili vlerëson hapat e ndërmarra nga skemat e sigurimit të depozitave për një periudhë tre vjeçare (përkatësisht tetor 2013 – tetor 2016) në drejtim të adoptimit dhe zbatimit të praktikave dhe standarteve më të mira të sigurimit të depozitave.

Ky vlerësim përfshinte, ndër të tjera, hapat e ndërmarra për zbatimin e një sistemi IT (teknologji informacioni) për monitorimin e subjekteve anëtare të skemës dhe raportimin automatik të të dhënave, llogaritjen e primit të sigurimit, si dhe kompensimin e depozituesve, në rast ngjarje sigurimi. Gjithashtu, ASD u vlerësua për një sërë reformash të rëndësishme ligjore, që bënë të mundur modernizimin e skemës. Një tjetër hap i rëndësishëm nga pikëpamja financiare, e vlerësuar nga komiteti i posaçëm i vlerësimit të IADI, ishte e drejta e ASD-së për të miratuar politikën e saj të investimit

të mjeteve financiare në mënyrë të pavarur. Kjo mundëson fleksibilitet më të madh në investim, pasi lejon marrjen në konsideratë të faktorëve të ndryshëm rregullativë, ekonomikë dhe ndryshimeve në tregun e letrave me vlerë, si dhe lejon diversifikim më të madh të portofolit të investimeve të ASD-së. Gjithashtu, në 2014 ASD nënshkroi një marrëveshje huaje me BERZH-in, e cila vë në dispozicion një linjë huaje prej 100 milionë euro, në rast ngjarje sigurimi. Kjo linjë huaje, që është një masë sigurie më tepër për depozituesit, i lejon ASD-së të përdorë fonde shtesë likuide, përtej fondeve të veta, në rast ngjarje sigurimi, një praktikë e cila u vlerësua në linjë me praktikatat më të mira për një sistem efektiv të sigurimit të depozitave.

Së fundmi, ASD u vlerësua pozitivisht për fushatat e saj të ndërgjegjësimit të publikut dhe hapat e ndërmarra në këtë drejtim.

2016 IADI 15th Annual General Meeting and Annual Conference

23-28 OCTOBER 2016 | SEUL, KOREA



Zhvillon punimet Forumi për Sigurinë e Informacionit

AAB dhe Komiteti për Sigurinë e Informacionit organizuan më 13 tetor 2016, Forumin për Sigurinë e Informacionit. Forumi u ndoq nga ekspertë të fushës nga bankat që operojnë në Shqipëri si dhe ekspertë ndërkombëtarë, përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Bankës së Shqipërisë, Shoqatës së Bankave të Kosovës, shoqërive të këshillimit, etj. Kjo veprimtari u organizua në kuadër të muajit të sigurisë, shpallur nga vendet e Bashkimit Evropian, gjatë të cilit u zhvillua një fushatë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit ndaj kërcënimeve të sigurisë kibernetike dhe të ofrojë informacion mbi sigurinë, përmes edukimit dhe ndarjes së eksperiencës dhe praktikave më të mira.



AAB dhe Shoqata e Bankave të Malit të Zi nënshkruajnë Memorandumin për partneritet dhe bashkëpunim

Më 30 dhjetor 2016, përfaqësuesit e Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) dhe të Shoqatës së Bankave të Malit të Zi (AMB) zhvilluan një takim për të nënshkruar Memorandumin për partneritet dhe bashkëpunim. Z. Spiro Brumbulli, Sekretari i Përgjithshëm i AAB dhe Z. Mirko Radonjić, Sekretari i Përgjithshëm i AMB, u takuan në mjediset e AAB-së për këtë moment të rëndësishëm. Kjo marrëveshje do të mundësojë kontributin e përbashkët në përmirësimin e imazhit të sektorit bankar dhe rritjen e besimit të publikut në të, si dhe shkëmbimin e përvojës profesionale. Gjithashtu, një nga objektivat kryesore të memorandumit është të analizojë legjislacionin bankar duke synuar përmirësimin e tij në përputhje me standardet ndërkombëtare.



Ligji “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”

Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së ishte pjesë e grupit të përfaqësuesve të 18 shoqatave të biznesit që kundërshtuan ligjin e ri “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”. Më 22 nëntor, këta përfaqësues morën pjesë në takim me z. Shpëtim Idrizi, Kryetar i PDIU dhe i Grupit Parlamentar të PDIU-së, ku kërkuan mbështetje nga ky grup parlamentar, specifikisht për mosmiratimin e ligjit, i cili është rikthyer nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, i cili bën të detyrueshëm anëtarësimin e biznesit në dhomat e tregtisë. Ky takim u organizua në kuadër të takimeve të tjera të mbajtura me përfaqësues të Kuvendit dhe letrave të dërguara gjithë institucioneve shtetërore dhe ambasadave të huaja. Në këtë kontekst, më 23 nëntor, përfaqësues të shoqatave të biznesit i shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me ndryshimin e ligjit për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë edhe gjatë një takimi me Z. Petrit Vasili, kryetar i Grupit parlamentar të LSI-së. Më 30 nëntor u mbajt një takim në mes shoqatave të biznesit dhe dhomave të tregtisë. Ky takim u transmetua nga TV Scan. Më 2 dhjetor, këta përfaqësues u takuan me Z. Edmond Spaho, kryetar i Grupit Parlamentar të PD-së. Media i raportoi gjerësisht të gjitha këto takime.



**DEPOZITAT NE LEKE "5 PER 5" DHE "7 PER 7"
SHIJONI RITJEN E KERKUAR
TE INVESTIMIT TUAJ!**



Dy Depozita të reja në Lekë.
Unike në Afate & në Interesa: deri në 5% për 5 vjet & deri në 7% për 7 vjet.
Fleksibilitet në tërheqje dhe mundësi kapitalizimi.
NJE BOTE MUNDESISH REALE.

 **INTESA SANPAOLO BANK**

   www.intesasanpaolobank.al

CALL CENTER
08006000 (Falas nga Albtelecom & Eagle) +355 4 2276000, +355 692080903

Bank of  **INTESA SANPAOLO**

Interesi i Depozitës aplikohet me baza vjetore, numri i ditëve/365. Të gjitha depozitat e qytetarëve në Bankën tonë janë të siguruar sipas ligjit "Për Sigurimin e Depozitave", më datë 22.05.2014, Ligji Nr. 53/2014. Depozita në Bankë sigurohet deri në shumën 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave www.asd.gov.al

Mbi miratimin e Paketës Ligjore

Në mbledhjen e datës 25 tetor 2016, Komisioni Parlamentar i Ligjeve, përfundoi miratimin e paketës ligjore për reduktimin e Kredive të Këqija, por jo vetëm, paketë kjo e cila përfshinte pesë projektligjet: “Për falimentimin”, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”; “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat” dhe “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor”.

Asambleja e AAB-së dhe Darka e Vitit të Ri

Takimi i fundit i Asamblesë të Anëtarëve AAB për vitin 2016 u mbajt më 14 dhjetor. Agjenda përfshinte dhe zgjedhjen e 3 (tre) anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të AAB-së, si dhe Kryetarin e dhe Nënkryetarin e ri të saj. Këto zgjedhje u kryen për shkak të përfundimit të mandateve të anëtarësimit të tre nga gjashtë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të AAB. Anëtarët e zgjedhur janë: Z. Silvio Pedrazzi, CEO, Intesa Sanpaolo Bank Albania; Z. Dritan Mustafa, CEO, Tirana Bank; Z. Andi Ballta, CEO, Banka Amerikane e Investimeve.

Asambleja gjithashtu votoi për zgjedhjen e Z. Periklis Drougkas, CEO i Alpha Bank Albania, si Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Z. Silvio Pedrazzi, CEO i Intesa Sanpaolo Bank Albania si zëvendës kryetar.

Në të njëjtën ditë, AAB organizoi dhe Darkën e Vitit të Ri, në të cilën morën pjesë drejtuesit dhe përfaqësues të bankave anëtare, të ftuar të veçantë nga ana e Bankës së Shqipërisë, si: Guvernatori, Zëvendës Guvernatori i Parë, Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Shefi i Kabinetit, Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe anëtarët e Bordit Editorial të revistës BANKIERI.



Auditi Bankar, leksion i hapur me studentët e masterit në UET

Më 1 dhjetor u zhvillua një leksion i hapur, me studentë e pedagogë të Fakultetit Ekonomik në UET. Zj. Dorida Stambolla, Drejtore e Auditit të Brendshëm në Raiffeisen Bank dhe Kryetare e Komitetit të Auditorëve të Brendshëm pranë Shoqatës Shqiptare të Bankave, e cila ishte e ftuar në leksion, foli mbi auditin bankar, rolin e tij dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare në auditimin e brendshëm, në kuadër të strategjisë së AAB-së për edukimin financiar.



Forum i nivelit të lartë mbi Integritetin e Korporatave

Më 12 dhjetor, ICC Albania me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës dhe në bashkëpunim me AAB-në, FIAA-n dhe partnerë të tjerë, organizoi një forum të nivelit të lartë për angazhimin e sektorit privat shqiptar mbi integritetin e korporatave. Përfaqësues të biznesit vendosën të iniciojnë Koalicionin e Biznesit në Luftën kundër Korrupsionit dhe për të punuar së bashku për një agjendë vjetore, duke përgatitur masat anti-korrupsion në sektorin privat si dhe formësimin e mjedisit për politikën e tyre anti-korrupsion.



Udhëtim - trajnim me gazetarët ekonomikë

AAB organizoi më 21-22 tetor 2016 në Mal të Zi, një seminar për 23 gazetarë të mediave të shruara, online dhe ato audiovizive. Programi i trajnimit u drejtua nga ekspertë të bankave nga Fibank, NBG Bank në Shqipëri, Societe Generale Albania dhe Tirana Bank. Pjesëmarrësit mësuan lidhur me disa aspekte të raportimit financiar, sistemit bankar dhe raport të tij me median, rrezikun e besueshmërisë dhe huat me probleme, bankingun online, digjitalizimin, sigurinë dhe transportin e parave, etj. Gjithashtu, një pjesë e rendit të ditës ishte dhe një vizitë në Shoqatën e Bankave të Malit të Zi në Podgoricë dhe një udhëtim në Kotor dhe Budva.



SME: nga plani i biznesit te financimit bankar", 11-13 tetor

Seminari synoi përmirësimin e ekspertizës teknike dhe tregtare të pjesëmarrësve në marrëdhëniet e tyre me NVM-të që aplikojnë për një hua për financimin e zhvillimit të veprimtarisë së tyre, kuptim më të mirë se çfarë është një kërkesë së mund të mbulohet me hua, bazuar në një biznes, si dhe përmirësimi i të kuptuarit të fjalëve kyçe në financimin e NVM-ve: "Informacion" - "Trajtim i informacionit" - "Përdorimi i informacionit". Trajnimi u ndoq nga 27 pjesëmarrës nga 9 banka anëtare.



"Menaxhimi i aplikuar i rrezikut në banka", 31 - 04 tetor

Qëllimi kryesor i kursit ishte t'i ofronte pjesëmarrësve një kuptim të mirë të menaxhimit të rrezikut për bankat. Metodologjia u bazua në leksione teorike, ushtrime të shumta praktike, ndërveprim dhe shkëmbim pikëpamjesh, raste studimore, etj. Kursi u drejtua nga z. Stefano Bragoli, anëtar i House of Training Quality Circle ALRiM in Risk Management, në të cilin morën pjesë 20 përfaqësues nga 11 banka në Shqipëri dhe Kosovë.



Negociatat Fitim-Fitim, 26 - 27 tetor

Programi u përqendrua në të mësuarit e pjesëmarrësve me konceptet themelore të gjithë pranuaratë bisedimeve, si dhe të taktikave për kryerjen e negociatave të vështira. Ai u ofroi atyre praktikën themelore në përgatitjen dhe kryerjen e negociatave të tyre sot dhe në të ardhmen. Pjesëmarrësit morën pjesë në dy simulime negociatash dhe patën mundësi të praktikoheshin, duke përdorur aftësitë e komunikimit në negociata. Programi u drejtua nga eksperti dhe trajneri David Turner.



Investo me UBS, 7 nëntor

Seminari ofroi mjete praktike për të përmirësuar proceset e shpërndarjes së aktiveve dhe menaxhimit të rrezikut, zbatimin e qasjeve novatore të menaxhimit të investimeve, si dhe zhvillimin e produkteve dhe zgjidhjeve të reja.



Zhvillimi i Ekipeve me Ecuri të Lartë nëpërmjet bashkëpunimit - 12 dhjetor

AAB organizoi seminarin me titull: " Ekipeve me Ecuri të Lartë nëpërmjet bashkëpunimit: Çfarë mund të bëjnë drejtuesit për të mundur dhe fuqizuar stafin e tyre që të bëhen më efikas dhe efektiv?", me trajnerin Mark Engelhardt. Seminari u ndoq nga 11 pjesëmarrës nga departamentet e burimeve njerëzore të bankave anëtare.



Parandalimi i Pastrimit të Parave & Financimit të Terrorizmit (AML & CTF) niveli bazë - 5-9 dhjetor

Ky trajnim u organizua me mbështetjen financiare të Shtëpisë së Trajnimeve, Luksemburg dhe për herë të parë u organizua një provim certifikimi për 16 pjesëmarrësit që morën pjesë në trajnimin në Tiranë. Të gjithë pjesëmarrësit e kaluan provimin me sukses.

